2011

PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE E QYTETARËVE

МЦМС

PËRGJEGJËSIA

Përgjegjësi për çështjet shoqërore

FRYMA PUBLIKE

Respektimi i obligimeve ligjore nga ana e qytetarëve

MJEDISI JETËSOR

Përgjegjësi ndaj mjedisit jetësor dhe natyrës

SHOQËRIMI

Kalimi i kohës me anëtarët e familjes, miqtë në rekreacion...

AKTIVITETI POLITIK

Pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitete jopartiake politike

BASHKËSIA

Aktivitet vullnetar në bashkësi

SHOQËRIA CIVILE

Pjesëmarrja dhe aktiviteti i qytetarëve në organizatat e shoqërisë civile

DHURIMI

Bamirësia përmes punës, mjeteve, diturisë dhe/ose të mirave

Botues
Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Për botuesit
Sasho Klekovski, drejtor i parë ekzekutiv
Aleksandar Kërzhallovski, drejtor ekzekutiv

Autorë

Sasho Klekovski	Përgjegjësi për çështjet shoqërore
Gonce Jakovleska	Niveli i socializimit; Fryma publike; Pjesëmarrja në aktivitete politike jopartiake; Bamirësia.
Daniella Stojanova	Aktiviteti vullnetar në bashkësi; Pjesëmarrja dhe aktiviteti i qytetarëve në organizatat e shoqërisë civile; Përgjegjësia për mjedisin jetësor.

Përgatitja
Daniella Stojanova, MCMS

ISBN 978-608-4617-17-4

Mendimet që janë shprehur këtu i takojnë autorit dhe nuk do to thotë se i reflekton qëndrimet e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar
Të gjitha të drejtat janë ruajtur.
Riprodhimi, kopjimi, transmetimi ose përkthimi i cilës do pjesë të këtij publikimi mund të bëhet vetëm me leje paraprake të botuesit ose për shkak të citimit.
Të drejtat e autorit të këtij publikimi janë mbrojtur, por publikimi mund të riprodhohet në cilën do qoftë mënyrë dhe pa pagesë për qëllime edukative. Për kopjimin në kushte tjera, për përdorimin në publikime tjera ose për përkthim ose adaptim, duhet të sigurohet leje paraprake nga botuesi.

PARATHËNIE

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar për të katërtën herë e hulumtoi përgjegjësinë shoqërore të qytetarëve.

Ndjenja për **përgjegjësi të qytetarëve për të ndikuar, pjesëmarrja dhe zgjidhja e problemeve shoqërore** është komponentë e rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë civile, por edhe të shoqërisë në përgjithësi. Shoqëria civile pa qytetarët të cilët marrin pjesë në atë nuk mund ta plotësojë misionin e vet. Kjo është shoqëri civile e rrënjosur dhe dinamike, i cili ndikim në politikat publike është qëllim afatgjatë i MCMS. Shoqëria e këtillë civile është e bazuar në qytetarë **aktivë** ose **qytetarë me përgjegjësi shoqërore,** si aktorë në shoqëri. Për këto shkaqe, MCMS e hulumton shoqërinë civile, e veçanërisht besimin dhe përgjegjësinë shoqërore të qytetarëve.

MCMS për herë të parë e hulumtoi përgjegjësinë shoqërore në vitin 2006, bashkë me besimin, derisa në vitet 2007, 2009 dhe 2010 u bënë hulumtime të veçanta. Raporti është përmirësuar në bazë të përvojave të mëparshme dhe hulumtimeve globale. Përdoren indekse për qëndrimet dhe shprehitë e qytetarëve për çështje të caktuara me çka lehtësohen analizat e trendëve. Me inkuadrimin e pyetjeve të reja, përsëritja periodike e hulumtimit, por edhe publikimi i tij në disa pjesë, është përdorimi më i mirë i raportit.

MCMS shpreson se raporti **"Përgjegjësia shoqërore e qytetarëve"** do të përdoret nga organizatat e shoqërisë civile për përmirësimin e strategjive të tyre për inkuadrim më të madh dhe mbështetje nga ana e qytetarëve. Raporti ofron informata të dobishme edhe për institucionet shtetërore, që mund të kontribuojë në procesin e krijimit të politikave. Gjithashtu, MCMS beson se analizat do të jenë të dobishme edhe për sektorin privat, por edhe për studentët dhe për hulumtuesit e dukurive shoqërore.

MCMS

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE 2

PËRMBAJTJA 3

INDEKSET 5

HYRJE 6
termet dhe definicionet 6
Indekset 7
Indekset e përgjegjësisë shoqërore 7
Metodologjia dhe qasja 8
Pyetësori 8
Ekzemplari 8
Përpunimi dhe prezantimi i rezultateve 8
Grupi punues 9

I PËRGJEGJËSIA PËR ÇËSHTJET SHOQËRORE 10
Pika e kontrollit dhe përgjegjësia 10
Mënyrat e zgjidhjes së nevojave shoqërore 12
Dimensionet kryesore të përgjegjësisë së qytetarëve 12
Përfundime 13

II FRYMA PUBLIKE 14
Përfundime 17

III NIVELI I SOCIALIZIMIT 18
Përfundime 20

IV PJESËMARRJA NË AKTIVITETE JOPARTIAKE POLITIKE 21
Përfundime 22

V AKTIVITETI VULLNETAR NË BASHKËSI 23
Përfundime 24

VI PJESËMARRJA DHE AKTIVITETI I QAYTETARËVE NË ORGANIZATZAT E SHOQËRISË CIVILE 25
Anëtarësimi i qytetarëve në organizatat e shoqërisë civile 25
Mënyra e inkuadrimit 26
Motivimi për inkuadrim 27
Përfundime 28

VII KONTRIBUTET BAMIRËSE 28
Pjesëmarrja e qytetarëve në kontribute bamirëse 28
Motivimi 29
Qëllimet e kontributeve bamirëse 31
Përfundime 32

VIII PËRGJEGJËSIA PËR MJEDISIN JETËSOR 34
Përfundime 36
Shtojcë. Pyetësori 38
Shtojcë. Struktura e ekzemplarit 43

INDEKSET

Përgjegjësi për zgjidhjen e çështjeve shoqërore	2010		2009
Shteti	50,5	↔	51,9
Sektori afarist	3,0	↔	1,6
Qytetarët	6,9	↔	6,9
Shteti, sektori afarist (privat) dhe qytetarët	33,4	↔	33,8
Përgjegjësia shoqërore e qytetarëve			
Respektimi i obligimeve ligjore/ligjeve	88,8	↓	92,1
Pjesëmarrja në aktivitete politike jopartiake	55,2	↓↓	62,8
Pjesëmarrja në aktivitete vullnetare e bashkësive	58,6	↔	57,1
Pjesëmarrja në aktivitete të organizatave të shoqërisë civile	58,0	↔	59,6
Dhurimi bamirës	64,5	↑↑	59,1
Ruajtja e mjedisit jetësor	92,4	-	-
Indeksi i përgjegjësisë shoqërore e qytetarëve	69,6	↑	66,1
Fryma publike			
Mos arsyetimi i fshehjes së tatimit, nëse ka rast për këtë	87,0	↓↓	92,2
Mos arsyetimi i kërkesës së lehtësimeve nga Qeveria për të cilat nuk ka të drejtë	93,7	↑↑	85,4
Mos arsyetimi i marrjes ose dhënies së mitës për punë që është obligim	93,0	↔	92,8
Mos arsyetimi i pagesës në të holla të gatshme për servise që të shmangen tatimet	62,6	-	-
Mos arsyetimi i mos pagesës së shërbimeve komunale	92,4	↔	91,2
Mos arsyetimi i shmangies që të paguhet transporti publik	93,5	↔	92,3
Mos arsyetimi i respektimit të dispozitave nga disa ligje	94,0	-	-
Indeksi i frymës publike	88,0	↓↓↓	90,8
Pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitete politike jopartiake në 5 vitet e fundit			
Peticioni	25,7	↓↓	31,7
Protesta (demonstrata, mitingu)	36,6	↓	40,4
Bojkoti	13,5	↓	16,7
Bllokimi i rrugëve dhe objekteve	5,9	-	-
Ditari i qytetarëve	6,4	↓↓	12,3
Indeksi i pjesëmarrjes së qytetarëve në aktivitete politike jopartiake	17,6	↓	25,3
Aktiviteti vullnetar në bashkësi			
Indeksi i pjesëmarrjes në aktivitet vullnetar në bashkësi	24,8	↔	27,4
Pjesëmarrja në organizatë të shoqërisë civile			
Indeksi i pjesëmarrjes në organizatat e shoqërisë civile	48,4	-	-
Indeksi i pjesëmarrjes në organizata qytetare	24,7	↔	23,9
Dhurimi bamirës			
Indeksi i dhurimit bamirës	65,1	↓↓	70,9

Legjenda

↔	pa ose me ndryshime të parëndësishme	Pa ose me ndryshime të parëndësishme = 0 – 3 pikë përqindjes Të vogla = 3,01 – 5 pikë përqindjes Të matura = 5,01 –10 pikë përqindjes Të mëdha = mbi 10 pikë përqindjes
↑	rritje e vogël	
↓	rënie e vogël	
↑↑	rritje e matur	
↓↓	rënie e matur	
↑↑↑	rritje e madhe	
↓↓↓	rënie e madhe	

HYRJE

Në këtë raport janë analizuar rezultatet nga anketa **"Përgjegjësia shoqërore e qytetarëve",** e cila u realizua në ekzemplar nacional dhe reprezentues të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Qëllimi i hulumtimit ishte të hulumtohet përgjegjësia qytetare për çështje shoqërore në Maqedoni.

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) ia besoi anketën e mendimit publik, mbi të cilën bazohet ky raport, Institutit për Hulumtime Sociologjike dhe Juridike-Politike (IHSJP), përgjegjësia e të cilit ishte edhe rregullsia metodologjike e anketës. Ky hulumtim u realizua për të katërtën herë. Hulumtimi i parë u zbatua në prill të vitit 2006 dhe u botua në publikimin "Besimi, përgjegjësia për çështjet shoqërore dhe bamirësia në Maqedoni". Hulumtimi i dytë dhe i tretë u realizua në dhjetor të vitit 2007 dhe mars 2009, të botuara "Përgjegjësia shoqërore e qytetarëve".

TERMET DHE DEFINICIONET

Përgjegjësia shoqërore mund të bazohet në ligj, etikë, moral ose e bazuar në fe ose bindjen (ideologjike). E njëjta ka të bëjë me qeverinë (sundimi i drejtë), në ndërmarrjet (përgjegjësia sociale ose shoqërore e ndërmarrjeve) ose në qytetarin (përgjegjësia qytetare). Ky hulumtim ka të bëjë me përgjegjësinë shoqërore të qytetarit në kuptimin e gjerë. Ai përbëhet prej dy elementeve, dhe atë në frymë publike dhe përgjegjësinë qytetare ose pjesëmarrjen qytetare (Civikus, 2004, 2011).

Fryma publike është tregues i mbështetjes së sundimit të drejtës (aplikimi i ligjeve). Fryma publike matet përmes mbështetjes së pagesës së tatimeve, transportit publik, shërbimeve komunale, mospranimin dhe mosdhënien e mitës dhe mos kërkimi i lehtësimeve nga Qeveria, për të cilat nuk ekziston e drejtë. Në këtë raport është përfshirë edhe respektimi edhe i disa dispozitave konkrete ligjore nga Ligji për siguri në komunikacion, Ligji për pastërti publike dhe Ligji për mbrojtjen nga duhani. Krahas asaj që është matur përgjegjësia personale, qytetarët u pyetën edhe nëse bashkëqytetarët e tyre e mbështetin zbatimin e ligjeve.

Përgjegjësia shoqërore e qytetarëve në kuptimin më të ngushtë është **përgjegjësia qytetare ose pjesëmarrja/angazhimi qytetar.** Ky nuk është obligim ligjor, por etnik, moral ose obligim i bazuar në bindje. Kjo matet përmes pjesëmarrjes së qytetarëve në: aktivitete nga natyra sociale dhe rekreative, aktivitete politike jopartiake, aktivitete vullnetare në bashkësi, në organizatat e shoqërisë civile, si dhe përmes pajtimit dhe arsyetimit të masave dhe aktiviteteve për ruajtjen e mjedisit jetësor dhe kontributeve bamirëse.

Socializimi është i lidhur ngushtë me përgjegjësinë shoqërore, pasi që përmes atij qytetarët fitojnë një pjesë të rëndësishme të shkathtësive të tyre, dituri, motive dhe qëndrime të nevojshme për kryerjen e roleve të tanishme dhe të ardhshme në shoqëri. Këto aktivitete të cilat shpesh janë të natyrës sociale ose rekreative, njëlloj si edhe aktivitetet tjera kontribuojnë në ndërtimin e kapitalit social.

Aktivitetet jopartiake politike kanë të bëjnë me aktivitetet si shkrimi i letrave deri te gazetat, nënshkrimi i peticioneve ose pjesëmarrja në protesta dhe bllokimi i rrugëve dhe objekteve, të cilat nuk janë organizuar nga partitë politike.

Aktiviteti vullnetar ka të bëjë me dhënien vullnetare të shërbimeve personale, njohurive dhe shkathtësive dhe/ose kryerjen e aktiviteteve tjera në dobi të personave tjerë, organeve, organizatave dhe institucioneve tjera, pa kompensim (Ligji për vullnetarizëm i Republikës së Maqedonisë). Nën bashkësi nënkuptojmë grup të njerëzve të cilët jetojnë në rajon të caktuar lokal, për shembull komunë, bashkësi lokale, këshilli i banesës etj.

Pjesëmarrja (inkuadrimi) në organizatë të shoqërisë civile nënkupton anëtarësim (aktive, joaktive, si edhe pagesa e anëtarësimit) dhe puna vullnetare (pa kompensim). MCMS e kupton gjerë shoqërinë civile, ndërsa e bazuar në definicionin e Civikus –

Indeksi i shoqërisë civile në Maqedoni (MCMS, 2011): Shoqëria civile është pjesë e hapësirës shoqërore jashtë familjes, shtetit dhe tregut, i krijuar nga ana e aksioneve individuale dhe kolektive, organizatave dhe institucioneve për shkak të arritjes së interesave të përbashkët. Sipas këtij definicioni në shoqërinë civile janë përfshirë shoqatat dhe fondacionet, odat ekonomike, organizatat e punëdhënësve, sindikatat, partitë politike dhe bashkësitë fetare.

Në Maqedoni, akoma nuk ka përkufizim edhe termeve filantropi dhe bamirësi, ose në përdorimin e termeve të ndryshme në gjuhën maqedonase, siç është bamirësia. Në këtë raport fokusi është në *kontributet bamirëse* si akt vullnetar i dhurimit të hollave ose të mirave.

Përgjegjësia ndaj mjedisit jetësor nënkupton ndjenjë për përgjegjësi të vetë qytetarëve që ta ruajnë mjedisin jetësor, si edhe dhënien e pëlqimit dhe arsyetimin për masat dhe aktivitetet e caktuar për mbrojtjen e segmenteve të ndryshme të mjedisit jetësor.

INDEKSET

Për përmirësimin e vlerës së përdorur të raportit dhe mundësia për analizë dhe krahasim, janë vendosur indekse (tregues), të cilët tregojnë qëndrim të qytetarëve ndaj ndonjë çështje të caktuar. Në raste të veçanta indekset janë të thjeshta dhe janë lidhur me një qëndrim, derisa indekset tjera janë më komplekse dhe vlera mesatare nga shuma e përgjigjeve të më shumë çështjeve.

Indekset për përgjegjësinë për zgjidhjen e problemeve shoqërore i përfshijnë përgjigjet e qytetarëve për atë se kush është përgjegjës për zgjidhjen e problemeve.

Indeksi i përgjegjësisë shoqërore të qytetarëve i përfshinë përgjigjet e qytetarëve se kanë përgjegjësi ti respektojnë ligjet, të marrin pjesë në aktivitete jopartiake politike, në aktivitete vullnetare t bashkësisë, në organizatat e shoqërisë civile, të japin kontribute bamirëse dhe ta ruajnë mjedisin jetësor.

Indeksi i frymës publike i përfshinë qëndrimet e qytetarëve se nuk është e arsyeshme të kërkohen lehtësime nga qeveria për të cilat nuk kanë të drejtë, të shmanget të paguhen shërbimet komunale dhe transporti publik, të pranohet mitë, si dhe të shmanget tatimi nëse për këtë ka rast.

Indeksi i pjesëmarrjes së qytetarëve në aktivitete jopartiake politike e përfshinë pjesëmarrjen e tyre në protesta dhe demonstrata dhe bllokimin e rrugëve dhe objekteve, pastaj nënshkrimin e peticioneve, mbështetja e bojkotit ose shfrytëzimi i ditarit qytetare.

Indeksi i aktivitetit vullnetar në bashkësi e reflekton pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitete për të mirën e bashkësisë në kuptim të mbledhjeve, aksioneve etj.

Indeksi i pjesëmarrjes në organizatë të shoqërisë civile flet për atë se sa qytetarë janë anëtarë (aktiv ose joaktiv) në të paktën një formë të shoqërimit të qytetarëve (organizata qytetare, bashkësi fetare, sindikata dhe parti politike. Indeksi i pjesëmarrjes në organizata qytetare tregoj sa qytetarë janë anëtarë aktivë ose joaktivë në organizatat qytetare (shoqatat).

Indeksi i dhurimit vullnetar flet për atë nëse dhe sa qytetarët dhurojnë për qëllime bamirëse (në të holla, të mira ose punë vullnetare).

Indekset e përgjegjësisë shoqërore

Indekse të	Опис
Përgjegjësia shoqërore	= Σ kanë përgjegjësi
Fryma publike	= Σ asnjëherë nuk është e arsyeshme
Pjesëmarrja në aktivitete jopartiake politike	= Σ ka marrë pjesë në pesë vitet e fundit/
Aktivitet vullnetar në bashkësi	= merr pjesë në aktivitete bamirëse
Pjesëmarrje në organizatat të shoqërisë civile	= Σ anëtar aktiv dhe jo aktiv
Dhurimi bamirës	= Σ ka dhuruar në 12 muajt e fundit

METODOLOGJIA DHE QASJA

Hulumtimi është zbatuar me anë të anketës gojore në amvisëritë në dhjetor të vitit 2010 në ekzemplar reprezentues prej 1.050 të anketuar.

Pyetësori

Pyetësorët për anketën janë ato që janë përdorur në tre hulumtimet paraprake, të ndryshuara në bazë të përvojave prej tyre dhe me inkuadrimin e pyetjeve nga metodologjia hulumtuese e Civikus – Indeksi i shoqërisë civile të Maqedonisë dhe hulumtimet tjera globale. Pyetjet janë përgatitur nga autorët.

Për plotësimin e qëllimeve të hulumtimit, me pyetësor janë përfshirë variabilet që vijojnë:

- Përgjegjësi për çështjet shoqërore;
- Fryma publike (respektimi i obligimeve ligjore të qytetarëve);
- Niveli i socializimit;
- Pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitete jopartiake politike të qytetarëve;
- Aktiviteti bamirës i qytetarëve në bashkësi;
- Pjesëmarrja dhe aktiviteti i qytetarëve në organizata të shoqërisë civile;
- Dhurimi bamirës i qytetarëve;
- Përgjegjësi ndaj mjedisit jetësor;
- Karakteristikat socio-demografike.

Ekzemplari

Anketa u realizua në dhjetor të vitit 2010 në ekzemplar reprezentues prej 1.050 të anketuarve. Korniza e popullatës së ekzemplarit ishte popullata më e vjetër se 18 vjet, ndërsa kriteret për reprezentim ishin: gjinia, përkatësia etnike, mosha, vendi i banimit dhe rajoni. Gjithashtu kishte kujdes për zgjedhjen e të anketuarve edhe sipas kritereve tjera, siç është arsimimi, përkatësia fetare etj.

Prej 1.050 të anketuarve, 49,7% ishin femra, ndërsa 50,3% meshkuj, lidhur me përfaqësimin etnik 63,2% të anketuarve ishin maqedonas, ndërsa 24,7% shqiptarë, derisa grupet tjera etnike ishin përfaqësuar me 12,1%. Lidhur me vendin e banimit, popullata rurale ishte përfaqësuar me 39,1%, derisa ajo e qytetit me 60,9% (qyteti i Shkupit me 21,1%). Pasqyra e plotë e ekzemplarit është dhënë në shtojcë.

Përpunimi dhe prezantimi i rezultateve

Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar me shpeshti dhe proporcion të përgjigjeve. Të dhënat janë me besueshmëri të saktësisë prej 95 % dhe me gabim +/- 5 %. Rezultatet janë prezantuar në grafikeve në nivel të gjithë ekzemplarit. Krahas grafikeve, të dhënat janë prezantuar edhe në numra. Gjithashtu janë prezantuar krahas numrave dhe trendëve në krahasim me hulumtimin paraprak të realizuar në mars të vitit 2009, për ato të dhëna të cilat mund të krahasohen me ato. Legjenda e simboleve për trendët është në rezymenë përfundimtare. Gjithashtu për përmirësimin e analizës të dhënave janë përdorur indekset e caktuara. Legjenda e simboleve është si vijon:

↔	pa ose me ndryshime të parëndësishme	Pa ose me ndryshime të parëndësishme = 0 – 3 pikë përqindjes Ndryshime të vogla = 3,01 – 5 pikë përqindjes Ndryshime të matura = 5,01 –10 pikë përqindjes Ndryshime të mëdha = mbi 10 pikë përqindjes
↑	rritje e vogël	
↓	rënie e vogël	
↑↑	rritje r matur	
↓↓	rënie e matur	
↑↑↑	rritje e madhe	
↓↓↓	rënie e madhe	

Në raport pakicë e parëndësishme përdoret për përgjigjet më të vogla se 10% nga ekzemplari, pakicë e vogël për 11% deri 30%, pakicë për 30% deri 50%, shumicë për 51% deri 70% dhe pakicë e madhe për më shumë se 70%.

Analizat socio-demografike për bashkësitë etnike me numër më të vogël dhe partitë politike me më pak simpatizues për shkak të pjesëmarrjes së tyre të vogël në ekzemplarin nacional nuk janë komentuar në këtë raport.

Në raport në tabela dhe grafike të caktuara nuk janë prezantuar rezultatet për “nuk e di” dhe “pa përgjigje”, për shkak se shuma e të gjitha përgjigjeve nuk është 100%. Kjo është bërë për nevojat e rrëfimit më të thjeshtë të rezultateve.

Grupi punues

Grupin punues e përbëjnë: Sasho Klekovski, Gonce Jakovleska, Emina Nuredinoska dhe Daniella Stojanovska.

I PËRGJEGJËSIA PËR ÇËSHTJET SHOQËRORE

Hyrjen në hulumtimin e përgjegjësisë shoqërore të qytetarëve është hulumtimi i qëndrimeve për pikën e kontrollit dhe për shpërndarjen e përgjegjësisë mes shtetit, sektorit afarist dhe civil, për atë se çka është përgjegjësia e qytetarëve, si mund të zgjidhen nevojat shoqërore dhe cilat janë qëndrimet për fushat e përgjegjësisë së qytetarëve.

PIKA E KONTROLLIT DHE PËRGJEGJËSIA

Janë hulumtuar qëndrimet për pikën e kontrollit (lokusi i kontrollit) dhe për shpërndarjen e përgjegjësisë për zgjidhjen e nevojave shoqërore mes tre sektorëve: shtetit, sektorit afarist dhe civil, si dhe qëndrimet për rritjen e përgjegjësisë së qytetarëve dhe të sektorit privat.

Pika e kontrollit referon deri në cilën shkallë individët besojnë se kanë kontroll mbi ngjarjet të cilat ndikojnë në jetën e tyre. Pika ose vendi i kontrollit mund të jetë i brendshëm ose i jashtëm (kur faktorët tjerë dhe aktorët e caktojnë jetën). Mesi aritmetik është 3,4 (shkalla 1-10).

Tabela I 1. Pika (lokusi) i kontrollit

(1) Kam kontroll mbi jetën time	81,1 %	18,9 %	Nuk kam kontroll mbi jetën time (10)

Ndjenjë më e vogël e kontrollit mbi jetën e vet kanë qytetarët e klasës më të ulët 928,8%) dhe me arsimim më të ulët (fillor 26,3%, dhe me arsimim të papërfunduar fillor 40,9%), si dhe simpatizuesit e LSDM (31,3%).

Pritje më të larta nga shteti kanë (50,5%), menjëherë pastaj janë pritjet për përgjegjësinë e përbashkët e tre sektorëve (33,4%), më të ulëta nga vetë qytetarët (7,2%) ose nga ndërmarrjet (3,0%). Qëndrimet janë të pandryshuara lidhur me hulumtimet paraprake nga viti 2007 dhe 2009.

Grafiku I 1. Kush është më përgjegjës për zgjidhjen e nevojave në shoqëri?



Grupe socio-demografike kanë qëndrime të ngjashme, si edhe në vitin 2009 dhe 2007. Pritje më të larta nga shteti ekzistojnë mes shqiptarëve etnik (56,8% në vitin 2010; 61,1% në vitin 2009), qytetarët me arsimim të papërfunduar fillor (63,6% në 2010; 65,5% në 2009), bujqit (63%) dhe qytetarët e klasës më të ulët (62,5%).

Qëndrimet e simpatizuesve të partive politike i ndjekin qëndrimet e bashkësive etnike. Simpatizuesit e LSDM kanë pritje më të larta nga shteti (55,6%), ndërsa simpatizuesit e VMRO-DPMNE janë më shpesh për përgjegjësi të ndarë (39,6%).

Në shtojcë të perceptimit të shtetit si më përgjegjës për zgjidhjen e nevojave në shoqëri janë edhe qëndrimet për rritjen e përgjegjësisë së qytetarëve edhe të sektorit privat, të analizuara më poshtë.

Se njerëzit duhet të ndërmarrin më shumë përgjegjësi për kujdesin për veten, mendojnë 55,9% të qytetarëve. Mesi aritmetik është 5,4 (shkalla prej 1 deri 10).

Tabela I 2. Përgjegjësi më e madhe për veten

Njerëzit duhet të ndërmarrin më shumë përgjegjësi për kujdesin për veten	55,9 %	44,1 %	Shteti duhet të ndërmerr më shumë përgjegjësi që secili ta ketë atë që i nevojitet.

59,9 % të qytetarëve mendojnë se duhet të rritet pronësia private mbi ndërmarrjet, ndërsa mesi aritmetik është 5,2 (shkalla prej 1 deri 10). Gjysma e qytetarëve (53,3%) mendojnë se shteti duhet tu japë më shumë liri ndërmarrjeve. Mesi aritmetik për këtë qëndrim është 5,6 (shkalla prej 1 deri 10).

Tabela I 3. Privatizim më i madh dhe liri e ndërmarrjeve

Duhet të rritet pronësia private e ndërmarrjeve.	59,9 %	40,1 %	Duhet të rritet pronësia shtetërore e ndërmarrjeve.
Shteti duhet tu japë më shumë liri ndërmarrjeve.	53,5 %	46,5 %	Shteti në mënyrë më efektive duhet ti kontrollojë ndërmarrjet.

Lidhur me qëndrimet për rritjen e përgjegjësisë së qytetarëve dhe ndërmarrjeve, ekzistojnë dallime në bazë të statusit social dhe arsimit, dhe deri diku përkatësisë etnike.

Qëndrimi se njerëzit duhet të ndërmarrin më shumë përgjegjësi për kujdesin për veten rritet me shkallën e arsimimit prej 22,7% në arsimin e papërfunduar fillor, deri 59,6% në arsimin e lartë/sipëror, si dhe me statusin social prej 45,2% në klasën më të ulët, deri 58,3% në klasën më të lartë. Qytetarët me arsim fillor më shumë janë për pronësi shtetërore (48,1%) dhe kontroll më efektiv (55,1%), ngjashëm si edhe me klasën më të ulët (54,8% gjegjësisht 56,7%). Qytetarët me arsim të mesëm dhe sipëror më shumë janë për rritjen e pronësisë private (57,5%; 69,7%) dhe për më shumë liri (56,4%); 53,3%), ngjashëm si edhe me klasën e mesme (63,1%; 58,6%).

Shumica prej 53,7% të shqiptarëve etnik presin që shteti të ndërmarr përgjegjësi më të madhe, përkundër 38,1% të maqedonasve etnik të cilët kanë pritje të tilla.

Tabela I 4. Qëndrime për përgjegjësinë sipas simpatizuesve të partive politike

	VMRO-DPMNE	LSDM
Kanë kontroll mbi jetën e tyre	83,9%	68,8%
Njerëzit duhet të ndërmarrin më shumë përgjegjësi për kujdesin për veten	64,3%	57,6%
Duhet të rritet pronësia private e ndërmarrjeve	59,1%	53,5%
Shteti duhet tu japë më shumë liri ndërmarrjeve	50,4%	57,6%

MËNYRAT E ZGJIDHJES SË NEVOJAVE SHOQËRORE

Qytetarët u pyetën për qëndrimet si mund të zgjidhen nevojat shoqërore.

Grafiku I 2. Nevojat shoqërore mund të zgjidhen me:



Zhvillim i ri, punësim dhje aftësimi i qytetarëve është mënyra e zgjidhjes së nevojave shoqërore për shumicën e qytetarëve (72,0%). Kërkesa e përgjegjësisë nga shteti dhe ndikimi mbi politikat publike është zgjidhje për 12,9% t qytetarëve, ndërsa ndihma sociale-humanitare është zgjidhje për 11,0% të qytetarëve. Zhvillimi i ri është në rritje të matur në krahasim me vitin 2009.

Qëndrimet janë relativisht homogjene dhe dallimet paraqiten krahas nivelit arsimor (ku kanë ekzistuar dallime edhe në vitin 2009/2007), në klasën dhe statusin e punës, edhe në moshën dhe përkatësinë etnike. Në ndihmën sociale-humanitare më shumë besojnë ata me arsim të papërfunduar fillor (45,5% në vitin 2010; 44,8% në vitin 2009), se sa ata me arsim sipëror (5,6^ në vitin 2010; 12,3% në vitin 2009). Qytetarët me arsim sipëror, si edhe klasat më të larta, më shumë besojnë në zhvillimin e ri. Për zhvillimin e ri si mënyrë e zgjidhjes së nevojave shoqërore më shumë janë deklaruar të rinjtë prej moshës 18 deri 29 vjet (77,7%), maqedonasit etnik (75,8%), derisa për ndihmën sociale-humanitare më shumë janë deklaruar personat me moshë mbi 65 vjet (20,4%), pensionistët (17,2%) dhe amviset (24,6%). Kërkesë për përgjegjësi nga shteti më shpesh janë deklaruar bujqit (25,9%) dhe shqiptarët etnik (18,1%).

DIMENSIONET KRYESORE TË PËRGJEGJËSISË SË QYTETARËVE

Grafiku I 3. Qytetarët kanë përgjegjësi:



MCMS e definon angazhimin qytetar, gjegjësisht përgjegjësinë shoqërore të qytetarëve në gjashtë fusha: respektimi i sundimit të drejtës (fryma publike), aktivitete jopartiake politike, vullnetarizmi në bashkësi, pjesëmarrja në shoqërinë civile, bamirësia dhe ruajtja e mjedisit jetësor.

Perceptimi më i lartë për përgjegjësi, qytetarët kanë në ruajtjen e mjedisit jetësor (92,4%), ndërsa më të ulët për pjesëmarrje në aktivitete jopartiake politike (55,2%). Në krahasim me vitin 2009 rritje të madhe ka perceptimi për përgjegjësi në ruajtjen e mjedisit jetësor, bamirësia e matur, stabil janë vullnetarizmi në bashkësi dhe pjesëmarrja në organizatat e shoqërisë civile, ndërsa ulje e vogël e matur paraqitet edhe pjesëmarrja në frymën publike dhe aktivitetet jopartiake politike.

Lidhur me grupet socio-demografike qëndrimet janë të ngjashme, me disa përjashtime. Përgjegjësi të respektohen ligjet perceptojnë 91,4% të maqedonasve etnike dhe 81,1% të shqiptarëve

etnik. Përgjegjësi për pjesëmarrje në aktivitete jopartiake politike perceptojnë më shumë bujqit (70,4%) dhe studentët (60,4%). Qytetarët e klasës më të lartë perceptojnë përgjegjësi më të vogël për pjesëmarrje në aktivitete jopartiake politike (41,7%), për vullnetarizëm në bashkësi (50%), për pjesëmarrje në shoqërinë civile (45,5) dhe për bamirësi (45,8%). Qytetarët e klasës më të ulët perceptojnë përgjegjësi më të vogël për respektimin e ligjeve (74%).

PËRFUNDIME

1. Shteti ende është më përgjegjës për zgjidhjen e nevojave shoqërore

Shumica e qytetarëve (50,5%) mendojnë se shteti është më përgjegjës për zgjidhjen e nevojave shoqërore. Nuk ka ndryshime në pritjet nga shteti (51,9% në vitin 2009).

Pritje më të larta nga shteti ekziston mes **shqiptarëve etnik** (56,8% në vitin 2011, 61,1% në vitin 2009), **bujqit** (63%) dhe qytetarët e **klasës më të ulët** (62,5%).

Pritjet e larta nga shteti, me pritjet e ulëta nga vetë qytetarët dhe pothuaj mungesa e pritjeve nga sektori privat, flet për kulturën etatiste, si mungesë e socializmit shtetëror, gjegjësisht mbështetje e vogël publike të rregullimit të Maqedonisë si sistem kushtetues liberal-demokratik. Kjo është pa ndryshim në krahasim me hulumtimet nga viti 2009, 2007 dhe 2004.

2. Zhvillim i ri – zgjedhje e nevojave shoqërore

Për atë se zhvillimi i ri, punësimi dhe aftësimi i qytetarëve janë zgjidhje për problemet, ekziston pajtueshmëri e lartë (72%). Ky qëndrim është rritur në mënyrë të matur nga viti 2009. Qëndrimet e këtilla të opinionit janë stabil dhe mund të jenë mbështetëse për vëmendje më të lartë të zhvillimit të ri përkundër ndihmës sociale.

Në ndihmën sociale-humanitare më shumë shohin zgjidhje qytetarët me nivel më të ulët të arsimimit (45,5%), si edhe te qytetarët më të moshuar (20,4%). Bujqit (25,9%) dhe shqiptarët etnik (18,1%) përsëri më shumë se niveli nacional (12,9%) presin përgjegjësi nga shteti.

3. Përgjegjësi më e madhe për veten, privatizim më i madh dhe liri e ndërmarrjeve

Se njerëzit duhet të ndërmarrin më shumë përgjegjësi për kujdesin për veten mendojnë 55,9% të qytetarëve, 59,9% të qytetarëve mendojnë se duhet të rritet pronësia private mbi ndërmarrjet, ndërsa 53,5% mendojnë se shteti duhet tu jep më shumë liri ndërmarrjeve.

Lidhur me qëndrimet për përgjegjësi të rritur të qytetarëve dhe ndërmarrjeve, ekzistojnë dallime në bazë të statusit social dhe arsimit dhe deri diku të përkatësisë etnike.

Qëndrimi se njerëzit duhet të ndërmarrin më shumë përgjegjësi për kujdesin për veten rritet me shkallën e arsimit prej 22,7% në arsimim të papërfunduar fillor, deri 59,6% në arsimin e lartë/sipëror, si edhe me statusin social prej 45,2% në klasën më të ulët, deri 58,3% në klasën më të lartë. Shumica prej 53,7% të shqiptarëve etnik presin shteti të ndërmerr përgjegjësi më të madhe, përkundër 38,1% të maqedonasve etnik të cilët kanë pritje të tilla.

4. Shqiptarët etnik – mes pritjeve të larta dhe besimit të ulët në shtet

Shqiptarët etnik mendojnë se më përgjegjës për zgjidhjen e nevojave në shoqëri është shteti (56,8%, përkundër 50,5% në ekzemplarin e përgjithshëm), se shteti duhet të ndërmerr përgjegjësi më të madhe që secili ta ketë atë që i duhet (53,7% përkundër 40,1% në nivel nacional) dhe se nevojat shoqërore mund të zgjidhen me kërkimin përgjegjësisë nga shteti dhe ndikimi i politikave publike 918,1% përkundër 12,9% nga ekzemplari nacional). Këto pritje të larta duhet të hulumtohen më tej dhe veçanërisht lidhja e tyre e mundshme me zvogëlimin e besimit në shtet, partitë politike dhe pushtetin lokal (Klekovski S. etj. 2010).

Tabela I 5. Dallimi mes qëndrimeve dhe realitetit për përgjegjësinë qytetare dhe pjesëmarrjen

	Përgjegjësi për	Treguesi
Fryma publike	88,8	88,0
Pjesëmarrja në aktivitete jopartiake politike	55,2	17,6
Pjesëmarrja në organizata të shoqërisë civile	58,0	48,4
Aktiviteti vullnetar në bashkësi	58,6	24,8
Dhurimi bamirës	64,5	65,1

II FRYMA PUBLIKE

Mbështetja e sundimit të drejtës ose frymës publike është hulumtuar përmes 17 pyetjeve.

Shumicë e madhe e qytetarëve edhe më tej mendojnë se nuk duhet të kërkohen beneficione nga Qeveria për të cilat nuk kanë të drejtë (93,7%), e mbështesin pagesën e tatimit (87%), ndërsa janë kundër dhënies së mitës (93%), shmangien e pagesës së transportit publik)93,5%) dhe shërbimeve komunale (93%). Ka rritje të matur te ata të cilët mendojnë se nuk duhet të kërkohen beneficione nga Qeveria për të cilat nuk kanë të drejtë për 8,3 pikë përqindjes dhe rënie e matur e mbështetjes së pagesës së tatimit për 5,2 pikë përqindjes.

Shumicë e madhe e qytetarëve mendojnë se nuk është e arsyetuar të pihet duhani në vende të ndaluara me ligj (88,3%), të vozisin i dehur (6,6%) dhe të hidhen mbeturinat në vende të cilat nuk janë të caktuara për ato (97,2%). Edhe pse në shumicë (62,6%) megjithatë më i vogël është numri i qytetarëve të cilët mendojnë se nuk është e arsyetuar të paguhet në të holla të gatshme për shërbime të ndryshme.

Grafiku II 1. Në çfarë shkalle mendoni se është e arsyeshme ose jo e arsyeshme:



Mbështetja e sundimit të drejtës është relativisht homogjene. Mbështetje më të vogël e mos kërkimit të benefincione ka te bujqit (85,2%), te ata me arsim të papërfunduar fillor (81,8%), te ata me ardhura më të ulëta deri 1.500 denarë (84,8%) dhe simpatizuesit e PDSH-së (84,7%). Njëlloj është edhe te pagesa e tatimit, më e vogël është mbështetja nga bujqit (74,1%), te ata nga klasa më e lartë (70,8%) dhe ata të klasës më të ulët (76%), te të anketuarit me arsim të papërfunduar fillor (72,7%), te ata me të ardhura deri 1.500 (75,8%), simpatizuesit e PDSH-së (76,3%) dhe banorët e Pollogut (75,6%).

Pagesa e shërbimeve siç janë lyerja e mureve, pastrimi dhe ndreqja në të holla të gatshme është pranuar në shoqërinë maqedonase, e prandaj mbështetja te kjo pyetje, edhe pse te shumica, është më e ulët. Mbështetje më e vogël mund të vërehet te shqiptarët etnik (56%) dhe te ata me religjion islam (51,5%), te bujqit (33,3%), klasa e ulët (48,1%), te ata me arsim të papërfunduar fillor (18,2%), të anketuarit me të ardhura mes 1.500 dhe 3.000 denarë (44,6%) dhe banorët e rajonit jugperëndimor (48,9%) dhe ai lindor (49%). Mbështetje më e shprehur për këtë qëndrim ka te banorët e rajonit të Vardarit (90%) dhe të Shkupit (71,6%) dhe te ata me të ardhura mes 15.000 dhe 24.000 denarë (72,2%).

Sa i përket dhënies së mitës, mbështetje më e vogël mund të vërehet te ata nga klasa e lartë (83,3%), simpatizuesit e PDSH-së (83,1%) dhe banorët e rajonit jugperëndimor (72,3%) dhe i Pollogut (85,6%).

Pagesën e transportit publik më pak e mbështesin bujqit (85,2%), ata të klasës më të ulët (85,6%), ata me arsim të papërfunduar fillor (86,4%), të anketuarit me të ardhura mes 1.500 dhe 3.000 denarë (86,5%), simpatizuesit e BDI-së (82,1%) dhe banorët e rajonit jugperëndimor (83%) dhe të Pollogut (86,7%). Njëlloj është edhe me pagesën e shërbimeve komunale, për pagesën e tyre mbështetje më të vogël ka te shqiptarët etnik (80,7%), te ata me religjion islam (84,3%), pjesëtarët e klasës më të lartë (83,3%) dhe klasës më të ulët (80,8%), te ata me arsim të papërfunduar fillor (81,8%), të anketuarit me të ardhura mes 1.500 dhe 3.000 denarë (83,8%), simpatizuesit e BDI (74,6%) dhe PDSH (81,4%) dhe banorët e rajonit jugperëndimor (85,1%).

Këtë vit, qytetarët u pyetën për tre pyetje të reja të cilat e plotësojnë pasqyrën për frymën publike. Shumicë e madhe prej tyre nuk e arsyetojnë pirjen e duhanit në vende të ndaluara me ligj. Megjithatë, mbështetje më të vogël ka te ata që nuk janë fetar (76,6%), bujqit (81,5%), te ata të klasës së lartë (62,5%), banorët e rajoneve rurale (81,5%), te ata me të ardhura mes 3.000 dhe 4.000 denarë (81,6%), simpatizuesit e PDSH (72,9%) dhe BDI (79,1%) dhe banorët e Pollogut (67,2%) dhe rajonin jugperëndimor (80,9%). Mos arsyetimi i vozitjes nën ndikim të alkoolit, mbështetje të vogël ka te ata që nuk janë fetar (86,5%) dhe simpatizuesit e PDSH (84,7%). Më e pa arsyetuar për qytetarët është hedhja e mbeturinave në vende që nuk janë caktuar për këtë. Mbështetje më të vogël mund të vërehet te ata që nuk janë fetar (92,8%), bujqit (92,6%) dhe banorët e rajonit jugperëndimor (90,4%).

Këtë vit për herë të parë u hulumtua mendimi i qytetarëve për atë se çfarë fryme publike kanë bashkëqytetarët e tyre. Mund të vërehet jaz mes perceptimit për veten dhe për të tjerët.

Grafiku II 2. Sa nga bashkëqytetarët (qytetarë të Republikës së Maqedonisë)



Më me pak besim ndaj pyetjes rreth beneficioneve nga shteti janë bujqit, 66,7% prej tyre mendojnë se pothuaj të gjithë ose shumica nga bashkëqytetarët kërkojnë beneficione për të cilat nuk kanë të drejtë. I tillë është rasti me ata me të ardhura mes 3.000 dhe 4.000 denarë (62,1%) dhe banorët e rajonit të Vardarit (68,6%). Banorët e rajonit jugperëndimor (56,4%) dhe të Pellagonisë (55,4%) mendojnë se askush ose shumë pak kërkojnë beneficione të tilla.

Sa i përket pyetjes së pagesës së tatimit, jo besim më të shprehur ndaj bashkëqytetarëve kanë banorët e rajonit të Vardarit (70%). Se pothuaj askush ose shumë pak nga bashkëqytetarët e fshehin tatimin mendojnë ata me të ardhura deri 1.500 denarë (43,9%) dhe banorët e rajonit jugperëndimor (50%) dhe të Pellagonisë (46,4%). Shumica e qytetarëve (57,6%) mendojnë se pothuaj ose shumë pak pranojnë/japin mitë për punë që (e) kanë obligim. Më të theksuar në këtë mendim janë ata që nuk janë religjioz (66,7%), simpatizuesit e PDSH (72,9%) dhe banorët e Pollogut (70,6%), të Vardarit (68,6%) dhe rajonit të Shkupit (68,2%). Banorët e rajonit të Pellagonisë (46,4%) dhe Jugperëndimor (45,7%) i japin më shumë mbështetje qëndrimit se pothuaj askush ose shumë pak pranojnë/japin mitë.

Pakicë e qytetarëve (44%) mendojnë për bashkëqytetarët e vet se nuk i paguajnë shërbimet komunale. Ky mendim më i shprehur është te ata që nuk janë fetar (53,2%), ata të klasës më të lartë (54,2%) dhe ata të klasës më të ulët (53,8%), të anketuarit me arsim të papërfunduar fillor (54,5%), banorët e Shkupit (60,8%) dhe të rajonit Lindor (56,9%). Banorët e rajonit Verilindor (62,2%),

Jugperëndimor (66%) dhe të Pellagonisë (68,8%) më shumë e mbështetin qëndrimin se pothuaj askush ose shumë pak nuk i paguajnë shërbimet komunale.

Shumica e qytetarëve (57,5%) mendojnë se pothuaj të gjithë ose shumica e bashkëqytetarëve pinë duhan në vende të ndaluara me ligj. Me qëndrimin e këtillë pajtohen shqiptarët etnik (70,3%), pjesëtarët e fesë islame (69,3%), studentët (74%), pjesëtarët e klasës më të lartë (70,8%) dhe klasë më të ulët (66,3%), banorët e rajoneve rurale (69,1%), ata me të ardhura mbi 24.000 denarë (65,5%), simpatizuesit e PDSH (76,3%) dhe të BDI (68,7%) dhe banorët e rajonit të Pollogut (88,3%). Më pak mbështetje për këtë qëndrim i japin pjesëtarët e klasës punëtore (47,3%), banorët e rajoneve urbane (44,1%), ata me të ardhura deri 1.500 denarë (36,4%), simpatizuesit e LSDM (47,2%) dhe banorët e rajonit Lindor (38,2%), të Pellagonisë (44,6%) dhe Verilindor (46,7%).

Jazi më i madh është për hedhjen e mbeturinave në vende që nuk janë caktuar për këtë, prej 2,8% të cilët mendojnë se është e arsyeshme deri 62,2% të cilët mendojnë se pothuaj të gjithë ose shumica e bashkëqytetarëve të tyre e bëjnë këtë. Mos besim më i shprehur ndaj bashkëqytetarëve kanë treguar ata që nuk janë religjioz (73,9%), banorët e Shkupit (78,8%) dhe të rajonit të Shkupit (76%) dhe të Vardarit (84,3%). Mbështetje më të vogël për këtë qëndrim i kanë dhënë shqiptarët etnik (49%), pjesëtarët e fesë islame (52,1%), amviset (46,2%), ata me arsim të papërfunduar fillor (40,9%), simpatizuesit e PDSH (44,1%) dhe BDI (41,8%) dhe banorët e rajonit Jugperëndimor (39,4%), Jugperëndimor (46,8%) dhe të Pellagonisë (47,3).

Fryma publike u kontrollua edhe përmes dy pyetjeve interesante.

Grafiku II 3. Njerëzit a duhet ta shohin punën e tyre ose nëse kanë informata për zbatimin e drejtësisë, të njëjtat duhet ti tregojnë para autoriteteve



Shumicë e madhe e të anketuarve (90,1%) mendojnë se njerëzit duhet ta shohin punën e tyre dhe të mos merren shumë me atë çfarë bëjnë ose flasin të tjerët.

Mbështetje më e vogël për këtë qëndrim vërehet te ata me arsim të papërfunduar fillor (77,3%). Shumicë e madhe (73,1%) tërësisht ose pjesërisht pajtohen me qëndrimin se nëse dikush ka informata që mund të ndihmojë në zbatimin e drejtësisë, duhet t'ia përcjellë informatën autoriteteve. Këtu mbështetje më të vogël kanë dhënë shqiptarët etnik (65,6%), bujqit (55,6%), amviset (60%), ata me të ardhura deri 1.500 denarë (51,5%) dhe ata me të ardhura mes 3.000 dhe 4.000 denarë (60.9%), simpatizuesit e PDSH (62,7%) dhe të BDI (64,2%) dhe banorët e rajonit të Pellagonisë (49,1%) dhe Jugperëndimor (58,5%). Mbështetja më e madhe është te punësuarit në sektorin publik (80,7%), te ata me të ardhura mbi 24.000 denarë (81,5%) dhe ata me të ardhura mes 4.000 dhe 5.000 (81,1%) dhe banorët e rajonit Juglindor (89,4%), Lindor (85,3%) dhe të Vardarit (82,9%).

PËRFUNDIME

1. Forcohet fryma e matur publike

Shumicë e madhe e qytetarëve (mes 87% dhe 97,2%) i japin mbështetje sundimit të drejtës. Ekziston përmirësim te kërkesa e beneficioneve nga ana e Qeverisë lidhur me vitin 2009 për 8.3 pikë përqindjes dhe 35,9 pikë përqindjes në raport me vitin 2007, kur mbështetja ka qenë 57,8%. Ka rënie vetëm te mbështetja për pagesën e tatimit, dhe atë për 5,2 pikë përqindjes në raport me vitin 2009.

2. Jaz i madh mes perceptimit për veten dhe bashkëqytetarët

Në gjashtë pyetjet ku është hulumtuar perceptimi për frymën publike të bashkëqytetarëve mund të vërehet jaz mes 59,4 pikë përqindjes, në pyetjen për hedhjen e mbeturinave në vende që nuk janë caktuar për këtë deri 36,4 për pyetjen për pagesën e shërbimeve komunale. Jazi mes perceptimeve për veten dhe për të tjerët është konstatuar edhe në hulumtimet tjera të MCMS (Stojanova, D. et alt., 2010).

3. Arsimimi dhe të ardhurat mujore ndikojnë në frymën publike

Të anketuarit me arsim të papërfunduar fillor te shumica e pyetjeve japin mbështetje më të ulët se mbështetja mesatare për sundimin e të drejtës. I njëjti është rasti edhe me ata me të ardhura më të ulëta.

III NIVELI I SOCIALIZIMIT

Përgjegjësia shoqërore është e lidhur ngushtë me socializimin, gjegjësisht me mënyrat me të cilat qytetarët fitojnë shkathtësi, dituri, motive dhe qëndrime të nevojshme për kryerjen e roleve të tanishme dhe të ardhshme në shoqëri. Niveli i socializimit është kontrolluar përmes pesë pyetjeve me të cilat shihet qytetarët sa kohë kalojnë me familjen më të ngushtë dhe/ose më të gjerë, me miqtë, me kolegët nga puna ose profesioni jashtë nga orari i punës, në vizitë tempujve fetar dhe forma të tjera të shoqërimit të organizuar në bashkësi.

Qytetarët më shpesh shoqërohen me miqtë (50,4%) dhe me familjen më të ngushtë ose më të gjerë (49,4%), ndërsa më pak me kolegët e punës (28,3%) dhe me njerëzit nga klubet sportive, organizatat rekrejuese ose hobi (10,7%). Pakicë janë edhe ata që shkojnë në tempuj fetar një herë në javë (20,2%). Në raport me hulumtimin paraprak, të realizuar në vitin 2009, ka rënie të vogël të kohës së kaluar me miqtë (52,1%) dhe familjen (50%), ndërsa rritje të kohës së kaluar me kolegët (për pothuaj tre pikë përqindjes) dhe të kohës së kaluar me njerëz nga klubet sportive, rekrejuese dhe hobi organizatat (për pothuaj dy pikë përqindjes). Në rritje është edhe koha e kaluar në tempujt fetar për më shumë se tre pikë përqindjes.

Më së paku një herë në javë me familjen takohen 75% të anketuarve të cilët e përshkruajnë veten si klasë e lartë. Bie koha e kaluar me familjen ndaj të anketuarve të cilët veten e përshkruajnë si klasë më e ulët (35,6%). Rënia e tillë mund të shihet edhe në raport me shkallën e arsimimit, prej atyre me arsim të përfunduar të lartë ose sipëror (53,6%), drejt atyre me arsim të papërfunduar fillor (22,7%). Ndikim ka edhe vendi i banimit, e kështu më së shumti kohë për familjen dhe miqtë ndajnë ata të rajonit të Shkupit (63,6%), e më së paku banorët e rajonit Verilindor (31,1%), gjegjësisht ata nga Shkupi (67,1%), përkundër atyre nga fshati (43,8%). Në kohën e kaluar me familjen ndikon edhe statusi i punës, e kështu bujqit (37%) dhe amviset (63,1%) janë dy shembujt në kufi. Sa i përket simpatizuesve të partive politike, ata të PDSH më së paku kohë i kushtojnë familjes *35,6%), për dallim nga simpatizuesit e BDI (58,2%) të cilët më shpesh shihen me familjen.

Me rritjen e moshës, bie shpeshtia e shoqërimit me miqtë, në nivel javor, prej 65,8% te të anketuarit prej 18 deri 29 vjet, në 35,4% te ata mbi 65 vjet. Shqiptarët etnik (58,3%) dhe pjesëtarët e fesë islame (58,1%) më shpesh shihen me miqtë se sa maqedonasit etnik (46,8%) dhe pjesëtarët e religjionit ortodoks (46,5%). Në raport me statusin e punës, më të shoqërueshëm janë studentët (72,5%), ndërsa më pak amviset (38,5%). Ata të klasës më të lartë veçojnë më shumë kohë për miqtë (75%) se sa ata të klasës më të ulët të mesme (45,1%). Edhe shkalla e arsimimit ndikon në atë se sa kohë kalojmë me miqtë, prej 31,8% te ata me arsim të papërfunduar fillor, deri 51,7% te të anketuarit me arsim të përfunduar të lartë dhe sipëror. Sa i përket të ardhurave mujore, nuk mund të vërehet rritje lineare e kohës së kaluar me miqtë prej atyre me të ulëta, drejt atyre me të ardhura më të larta, edhe pse më së shumti me miqtë shoqërohen ata që kanë të ardhura mbi 24.000 denarë për anëtar të amvisërisë. Si edhe te përkatësia etnike dhe religjioze, dallime ka edhe te simpatizuesit e partive politike. Simpatizuesit e VMRO-DPMNE (47%) dhe të LSDM (46,5%) më pak shoqërohen me miqtë, se sa simpatizuesit e BDI (62,7%) dhe PDSH (62,7%). Banorët e rajonit Lindor (69,6%) shoqërohen më së shumti me miqtë, ndërsa ata të rajonit të Pellagonisë (33,9%) më së paku.

Meshkujt, në nivel javor, më shpesh shoqërohen me kolegët nga puna (33,7%), se sa gratë (22,8%). Siç rritet mosha, ashtu bie shoqërimi me kolegët prej 36,1% te ata të moshës mes 18 dhe 29 vjet, deri 19,5% te ata mbi 65 vjet, gjegjësisht studentët më së shumti shoqërohen mes veti (46,2%), për dallim nga pensionistët (18,8%) dhe amviset (16,9%). Edhe përkatësia etnike dhe religjioze ndikon në llojin e socializimit, e kështu shqiptarët etnik (36,7%) dhe pjesëtarët e fesë islame (34,3%) më shumë shoqërohen për dallim nga maqedonasit etnik (26,4%) dhe të krishterët ortodoks (25%). Të anketuarit të cilët e përshkruajnë veten si klasë e lartë (50%) dhe ata me të ardhura mbi 24.000 denarë për anëtar në amvisëri (39,5%) shoqërohen më së shumti me kolegët, se sa ata që e përshkruajnë veten

si pjesëtarë të klasës më të ulët të mesme (23,9%) dhe ata me të ardhura mes 5.001 dhe 6.500 denarë (18,3%). Edhe arsimi ndikon në shoqërimin me kolegët, siç rritet shkalla e arsimit të kryer, ashtu rritet shoqërimi me kolegët prej 13,6% te ata me arsim të papërfunduar fillor, deri 29,2% te ata me arsim të përfunduar të lartë dhe sipëror. Simpatizuesit e VMRO-DPMNE (25,2%) dhe LSDM (29,2%) më pak shoqërohen me kolegët se sa simpatizuesit e BDI (35,8%) dhe PDSH (40,7%). Si edhe te llojet tjera paraprake të socializimit, edhe këtu banorët e rajonit Lindor më së shumti shoqërohen me kolegët (50%), ndërsa më pak ata nga rajoni i Pellagonisë (16,1%).

Grafiku IV 1. Shpeshtia e kalimit të kohës me familjen, me miqtë, me kolegët, në tempujt fetar dhe në format e organizimit për shoqërim



Meshkujt (24,2%) më shpesh shkojnë në objekte fetare se sa femrat (16,1%). Shqiptarët etnik (45,6%) dhe pjesëtarët e religjionit islam (41,2%) më shpesh shkojnë në objekte fetare, se sa maqedonasit etnik (10,5%) dhe të krishterët ortodoks (10,3%). Gjithsej 44,9% të qytetarëve religjioz shkojnë në objekte fetare një herë në javë ose disa herë në vjet (57,7%). Qytetarët e klasës më të lartë (4,2%) dhe ata me të ardhura mes 5.001 dhe 6.500 denarë (13,5%) më rrallë shkojnë në objekte fetare, ndërsa më shpesh shkojnë ata të klasës më të ulët (25%) dhe ata me të ardhura deri 1.500 denarë (31,8%). Të anketuarit me arsim të përfunduar fillor (28,8%) janë vizitues më të shpeshtë të objekteve fetare, për dallim nga ata me arsim të kryer t lartë ose sipëror (17,9%). Dhe në këtë lloj të socializimit ka dallim mes simpatizuesve kushtimisht thënë partive të maqedonasve etnik dhe ata të shqiptarëve etnik. Simpatizuesit e VMRO-DPMNE (10%) dhe LSDM (7,6%) më rrallë shkojnë në objekte fetare, për dallim nga simpatizuesit e BDI (49,3%) dhe të PDSH (50,8%). Sipas vendit të banimit, shkuarja në objekte fetare është më e shpeshtë në mjediset rurale (28,2%), për dallim nga mjediset urbane (13,9%), ndërsa në sipas rajoneve, banorët e Pollogut (37,8%) më shpesh, ndërsa banorët e rajonit Lindor më rrallë (3,9%) shkojnë në objekte fetare.

Në shoqërimin e njerëzve në klube sportive, rekrejuese ose hobi organizata, shkollat për vallëzim dhe tjera ndikojnë mosha, profesioni, të ardhurat në amvisëri dhe rajoni ku banojnë. Shoqërim të këtillë më të madh ka te popullata më e re, e kështu 14,5% të atyre mes moshës 18 dhe 29 vjet së paku një herë në javë e praktikojnë këtë, për dallim nga 3,5% të atyre mbi 65 vjet. Më aktiv janë studentët (19,8%), e më së paku aktiv janë amviset (4,6%) dhe pensionistët (5,5%). Ata nga klasa më e lartë (29,2%) dhe ata me të ardhura mbi 24.000 denarë (17,6%) janë më aktiv nga klasa punëtore (8,8%) dhe ata me të ardhura deri 1.500 denarë (1,5%). Sipas vendit të banimit, banorët e rajonit të Vardarit (17,1%) janë më aktiv, ndërsa ata të rajonit Lindor – më pak aktiv (5,9%).

PËRFUNDIME

1. Familja dhe miqtë janë zgjidhja më e shpeshtë për shoqërim të qytetarëve

Edhe pse është në rënie të vogël në raport me vitin 2009, qytetarët ende më së shumti kohë kalojnë me miqtë (50,4%) dhe me familjen më të ngushtë ose më të gjerë (49,4%). Në rritje të vogël është (mes 2 dhe 3 pikë përqindjes) edhe koha e kaluar me kolegët e punës (28,3%) dhe me njerëzit nga klubet sportive, rekrejuese ose hobi organizatat (10,7%). Edhe pse tani qytetarët shkojnë më shpesh në tempujt fetar se sa në vitin 2009, megjithatë ata të cilët bëjnë këtë më shpesh janë akoma pakicë (20,2%).

2. Ndaj socializmit ndikojnë mosha, mjetet financiare dhe arsimi

Më të rinjtë, ata me të ardhura më të larta dhe ata me arsim të kryer të lartë dhe sipëror më shpesh shoqërohen me miqtë, kolegët dhe ,ë shumë kohë ndajnë për aktivitete sportive ose rekrejuese. Më shumë kohë të lirë, më shumë të holla ose vetëdije më të lartë, ose të gjitha bashkë ndikojnë në vendimin që të ndahet më shumë kohë për këto aktivitete. Rezultatet nga këto gjithsesi do jetë kapital i rritur social i cili në shtigje më të gjata mund të materializohet, sipas nevojave.

3. Përcaktimi etnik dhe religjioz ndikojnë në kohën e ndarë për miqtë, kolegët dhe vizitës tempujve fetar

Shqiptarët etnik dhe pjesëtarët e religjionit islam veçojnë më shumë kohë për shoqërim me miqtë, kolegët dhe për vizitë tempujve fetar, se sa maqedonasit etnik dhe pjesëtarët e religjionit të krishterë ortodoks. Dallimi lëviz prej 9,8 pikë përqindjes te shoqërimi me kolegët, deri 33 pikë përqindjes te vizita tempujve fetar. Dallimet e këtilla reflektohen edhe te simpatizuesit e partive kushtimisht thënë nga blloku politik maqedonas dhe shqiptar. Simpatizuesit e BDI dhe PDSH më shpesh shoqërohen me miqtë , kolegët dhe më shumë kohë ndajnë për vizitë tempujve fetar, se sa simpatizuesit e VMRO-DPMNE dhe LSDM.

4. Meshkujt më shpesh shoqërohen me kolegët dhe i vizitojnë tempujt fetar

Dallimet gjinore nuk janë rast i shpeshtë në hulumtimin për përgjegjësinë shoqërore të qytetarëve, por në këtë rast ato lëvizin mes 10,9 pikë përqindjes te shoqërimi me kolegët dhe 8,1 pikë përqindjes te vizita e tempujve fetar.

IV PJESËMARRJA NË AKTIVITETE JOPARTIAKE POLITIKE

Pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitete jopartiake politike është matur përmes: pjesëmarrjes në peticione, protesta, bojkote, plotësimin e ditarit të qytetarëve dhe bllokimin e rrugëve dhe objekteve. E fundit është kategori e re në krahasim me hulumtimin paraprak nga viti 2009.

Në pesë vitet e fundit, te aktivitetet jopartiake politike pjesëmarrja më e madhe ka qenë në protesta (36,6%), ndërsa më e vogël te bllokimi i rrugëve dhe objekteve (5,9%). Një e katërta e qytetarëve (25,7%) kanë nënshkruar peticione, ndërsa 13,5% aktivitetin e tyre e kanë shprehur përmes bojkotimit të prodhimeve të caktuara ose mos pagesës së llogarive. Sa i përket plotësimit të ditarit të qytetarëve, këtë e kanë bërë 6,4% të anketuarve.

Në raport me vitin 2009, kur është realizuar hulumtimi paraprak, mund të vërehet rënie në katër aktivitetet e para jopartiake politike. E fundit nuk mund të krahasohet për shkak se më parë nuk është hulumtuar. Rënia lëviz prej 6 pikë përqindjes te nënshkrimi i peticionit, deri 3,2 pikë përqindjes te bojkoti.

Në përgjigjet për pjesëmarrjen në protesta mund të vërehet ndikimi i karakteristikave socio-demografike. Meshkujt (42,2%) më shpesh kanë marrë pjesë në protesta në krahasim me gratë (30,8%). Edhe vitet ndikojnë në aktivitetin e këtillë jopartiak politik, e kështu ata të moshës mes 30 dhe 39 vjet më shpesh kanë marrë pjesë në protesta, ndërsa më rrallë e kanë bërë këtë ata të moshës mbi 65 vjet (24,8%). Ekzistojnë dallime në raport me prejardhjen etnike dhe përkatësinë fetare të anketuarve. Shqiptarët etnik (46,7%) më shpesh kanë protestuar se sa maqedonasit etnik (33%) dhe pjesëtarët e religjionit islam (44%) kanë protestuar më shumë se sa të krishterët ortodoks (32,6%). Sa i përket statusit të punës, më aktiv në protesta kanë qenë bujqit (51,9%), ndërsa më pak aktiv amviset (13,8%). Në protesta më shumë kanë marrë pjesë ata të klasës më të lartë të mesme, ata me të ardhura mbi 24.000 denarë për kokë në amvisëri (45,4%) dhe ata me arsim të papërfunduar fillor (45,4%). Dallime ka edhe në bindjet dhe qëndrimet, e kështu ata të cilët në shkallën politike njihen si djathtë nga qendra, më shumë kanë marrë pjesë në protesta. Nga simpatizuesit e partive politike, më aktiv kanë qenë ata të PDSH (52,5%), ndërsa më pak ata të VMRO-DPMNE (36,5%). Banorët e rajonit Lindor (55,9%) janë më aktiv në protesta, ndërsa ata të Pellagonisë (17%) më pak aktiv.

Grafiku IV.1. Pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitete jopartiake politike



Nënshkrimi i peticionit si aktivitet jopartiak politik më së shumti ithtarë të vet ka mes atyre me arsim të përfunduar të lartë ose sipëror (37%), të anketuarit me të ardhura mbi 24.000 denarë (39,5%) dhe ata të cilët veten e llogarisin si klasë e lartë (37,5%). Të anketuarit nga rajoni i Vardarit (45,7%) më së shpeshti kanë nënshkruar peticione, ndërsa më rrallë këtë e kanë bërë ata nga rajoni Jugperëndimor (14,9%).

Bojkotin më shpesh e kanë aplikuar të anketuarit të cilët veten e përshkruajnë si klasë më e ulët (24%) dhe ata me arsim të papërfunduar fillor (31,8%). Në pikëpamje të statusit të punës, më shpesh e kanë aplikuar bujqit (22,2%). Banorët e rajonit verilindor më shpesh e kanë përdorur bojkotin

(21,1%), për dallim nga banorët e rajonit Juglindor të cilët më rrallë (3,2%) kanë bojkotuar prodhime të caktuara ose pagesën e llogarive.

Edhe pse në vitin 2009 28,4% të anketuarve kanë thënë se do ta përdorin ditarin e qytetarit në të ardhmen, numri i atëhershëm prej 12,3% jo vetëm që nuk është rritur, por ka rënë në 6,4%. Nga përgjigjet mund të vërehet se simpatizuesit e BDI (17,9%) më shpesh e përdorin ditarin e qytetarit për ankesa ose lavdërime.

Edhe aktiviteti i fundit i hulumtuar, bllokimi i rrugëve dhe objekteve, nuk ka qenë i përdorur aq shpesh në pesë vitet e fundit. Më shpesh e kanë përdorur bujqit (18,5%).

PËRFUNDIME

1. Rënie e aktiviteteve jopartiake politike të qytetarëve

Rënie e vogël deri te e matur në të gjitha fushat e hulumtimit dhe lëviz nga 3,2 pikë përqindjes te bojkoti, deri 6 pikë përqindjes te nënshkrimi i peticionit.

2. Bujqit më aktiv në aktivitetet jopartiake politike

Bile 51,9% të bujqve kanë marrë pjesë në protesta në pesë vitet e fundit, ata më shpesh e përdorin edhe bojkotimin (22,2%) dhe bllokimin e rrugëve dhe objekteve (18,5%).

3. Arsimi ndikon në zgjedhjen e aktivitetit jopartiak politik

Ata me arsim të lartë ose sipëror i preferojnë peticionet si mënyrë e shprehjes së kënaqësisë ose pakënaqësisë (37%), ndërsa ata me arsim të papërfunduar fillor, protestat (45,5%) dhe bojkotin (31,8%).

V AKTIVITETI VULLNETAR NË BASHKËSI

Pjesë e rëndësishme nga përgjegjësia shoqërore e qytetarëve paraqet edhe inkuadrimi i tyre aktiv në aktivitetet vullnetare në bashkësi. Kjo përfshin pjesëmarrjen në mbledhje në të cilat diskutohet për problemet në bashkësi (komuna, bashkësia lokale, kështilli i banesës/bashkësia e pronarëve etj.), pjesëmarrje vullnetare në aktivitet e dobishme për bashkësinë (p.sh. pastrimi i rrugëve dhe sipërfaqeve tjera publike), ose ndihma njerëzve të tjerë nga bashkësia pa kompensim për këtë.

Pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitete vullnetare në bashkësi është matur me ndihmën e dy pyetjeve, nëse qytetarët kanë marrë pjesë në aksione vullnetare në bashkësi dhe nëse kanë marrë pjesë, sa kohë në vjet kanë përdorur për këto aktivitete.

Grafiku V 1. Pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitete vullnetare në bashkësi



Një e pesta ose 21,9% të qytetarëve kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në aktivitete vullnetare në bashkësi në vitin 2010, prej të cilëve 59,1% meshkuj dhe 40,9% femra. Pjesëmarrja në aktivitetet vullnetare në bashkësi shënon rënie të vogël në raport me vitin 2009, kur 27,4% kanë deklaruar se kanë marrë pjesë. Në vitin 12,8% të qytetarëve kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në aktivitete vullnetare në bashkësi, ndërsa 18,3% se kanë marrë pjesë në mbledhje. Informimi për aktivitetet vullnetare në bashkësi janë në nivel të njëjtë, 23,3% të qytetarëve kanë thënë se nuk ka pasur aktivitete të tilla në bashkësinë e tyre në vitin 2010, derisa në vitin 2009 kjo përqindje ka qenë 20,5 %.

Përkatësia etnike dhe religjioze nuk kanë ndikim mbi pjesëmarrjen në aktivitetet vullnetare në bashkësi.

Në krahasim me moshën, qytetarët e moshës prej 40 deri 65 vjet kanë qenë më aktiv në vitin 2010.

Ndryshime vërehen në statusin e punës dhe social dhe nivelin e arsimimit. Amviset pothuaj edhe nuk marrin pjesë në aktivitetet vullnetare në bashkësi (1,5%), ndërsa më aktiv janë të punësuarit në sektorin publik (33,2%), pensionistët (28,9%) dhe studentët (23,1%). Qytetarët me arsim sipëror (27,6%) dhe arsim të mesëm (20,4%) janë më aktiv nga qytetarët me arsim të papërfunduar fillor (15,4%).

Gjithashtu, ndryshime ka edhe në raport me vendin e banimit, qytetarët e Shkupit (31,1%) janë më aktiv në krahasim me mjediset tjera urbane (16,1%) dhe rurale (22,9%). Si plotësim i kësaj qytetarët e rajonit të Shkupit (34,1%) janë më aktiv se sa qytetarët nga rajonet tjera.

Tabela V 1. Struktura gjinore në aktivitetet vullnetare në bashkësi sipas vendit të banimit dhe përkatësisë etnike

	Rurale (fshat)		Urbane (qytet)		Shkup		Maqedonas		Shqiptarë	
Viti	**2010**	**2009**	**2010**	**2009**	**2010**	**2009**	**2010**	**2009**	**2010**	**2009**
Meshkuj	**66,0 %**	67,1 %	**56,7 %**	53,2 %	**52,2 %**	58,9 %	**48,3 %**	54,9 %	**74,1 %**	68,1 %
Femra	**34,0 %**	32,9 %	**43,3 %**	46,8 %	**47,8 %**	41,1 %	**51,7 %**	45,1 %	**25,9 %**	31,9 %
Gjithsej	100 %		100 %		100 %		100 %		100 %	

Për krahasim, të dhënat për përkatësinë etnike dhe vendin e banimit në raport me strukturën gjinore të qytetarëve të cilët kanë marrë pjesë në aktivitete vullnetare tregojnë se gratë në mjediset rurale janë dukshëm më pak aktive vullnetarisht në bashkësi në krahasim me gratë në mjediset urbane dhe se shqiptaret etnike janë dukshëm më pak aktive vullnetarisht në krahasim me maqedonaset etnike.

Dallime më të mëdha paraqiten edhe në bazë të simpatizimit të partive politike. Qytetarët të cilët janë deklaruar si simpatizues të VMRO-DPMNE (31,3%) dhe PDSH (30,5%) janë më aktiv nga qytetarët tjerë.

Tabela V 2. Aktiviteti vullnetar sipas simpatizuesve të partive politike

	VMRO-DPMNE	LSDM	BDI	PDSH	DR	Tjetër	Nuk jam simp.	Gjithsej
Ka marrë pjesë	31,3 %	17,4 %	23,9 %	30,5 %	23,8 %	36,5 %	15,2 %	21,9 %

Grafiku V 2. Koha e kaluar në pjesëmarrje në aksione vullnetare në nivel vjetor



Në raport me vëllimin e angazhimit vullnetar, pjesa më e madhe e qytetarëve (63,3%) të cilët kanë marrë pjesë në aktivitetet në bashkësi kanë përkushtuar 10 orë në vjet. Në krahasim me vitin 2009 është zvogëluar numri i qytetarët të cilët kalojnë më shumë se 10 orë në vjet në punë vullnetare në bashkësi (2010: 5,8%; 2009: 14,5%).

Karakteristikat socio-demografike të cilat i shënojnë qytetarët të cilët kanë marrë pjesë në aktivitete vullnetare në bashkësi janë ruajtur edhe në krahasim me vëllimin e angazhimit vullnetar.

PËRFUNDIME

1. Angazhim i vogël vullnetar në bashkësi.

Pakicë e qytetarëve (21,9%) inkuadrohet vullnetarisht në aktivitetet për bashkësinë (mbledhje, aksione). Prej atyre që janë inkuadruar, pjesa më e madhe (63,3%) ndajnë më shumë se 10 orë në vjet për këto aktivitete.

Angazhimi i vogël vullnetar edhe në pjesëmarrje edhe në vëllim, mund të llogaritet se është i njëhershëm dhe ad-hok dhe që flet për vetëdije të pandërruar që të bëhet diçka më shumë për bashkësinë dhe për bashkëqytetarët. Shkaku tjetër mund të jetë edhe mungesa e aktiviteteve në bashkësi, ku qytetarët do të kishin marrë pjesë d.m.th. 23,3% të qytetarëve kanë thënë se nuk ka pasur aktivitet vullnetar në bashkësinë e tyre. Por, kjo flet edhe për iniciativën e vogël edhe te qytetarët edhe te organizatat dhe institucionet tjera për aktivitete vullnetare.

Në raport me vitin 2009 vërehet rënie e matur e angazhimit vullnetar, si edhe pjesëmarrja në aktivitete, ashtu edhe në vëllimin e kohës së shpenzuar për ato.

2. Përkatësia gjinore ndikon në angazhimin vullnetar.

Edhe pse në nivel të ekzemplarit, nuk ka dallime të dukshme në pjesëmarrjen e meshkujve dhe grave në aktivitetet vullnetare për bashkësinë dhe distribuimi përgjigjet në popullatën e përgjithshme në vend, gjinia luan rol të rëndësishëm në grupe të caktuara socio-demografike. Amviset pothuaj edhe nuk marrin pjesë në aktivitetet në bashkësi (1,5%). Gratë nga bashkësitë rurale janë shumë më pak aktive se sa meshkujt, veçanërisht te bashkësia etnike shqiptare.

VI PJESËMARRJA DHE AKTIVITETI I QAYTETARËVE NË ORGANIZATZAT E SHOQËRISË CIVILE

Pjesëmarrja dhe aktiviteti i qytetarëve në organizatat e shoqërisë civile janë hulumtuar përmes pyetjeve a janë anëtarë në organizata të shoqërisë civile, në cilët sektorë punojnë organizatat ku janë anëtarë, a paguajnë anëtarësim, a punojnë vullnetarisht dhe çka i motivon të jenë aktiv në organizatat e shoqërisë civile.

ANËTARËSIMI I QYTETARËVE NË ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

Qytetarët në Republikën e Maqedonisë të drejtën e shoqërimit mund ta realizojnë përmes shoqërimit në shoqata dhe fondacione, sindikata, shoqata afariste, parti politike, bashkësi fetare, Kryqi i Kuq i Maqedonisë etj. Këto forma të shoqërimit janë rregulluar me ligje të veçanta.

Grafiku VI 1. Inkuadrimi në punën e disa formave të shoqërimit



Një pakicë e qytetarëve janë anëtarë në çfarëdo forme të shoqërimit. Partitë politike janë më tërheqëse për qytetarët, gjegjësisht 37,5% prej tyre janë anëtarë në këtë tip të shoqërimit, prej të cilëve 18,4% janë aktiv. Partitë politike gëzojnë besimin më të ulët të qytetarëve në krahasim me format tjera të shoqërimit (Klekovski S. etj., 2010). Qytetarët më së paku janë anëtarë në sindikata (24,2%) dhe në organizata qytetare (24,6%), ku anëtarësia aktive përbëhet prej 6,4% d.m.th 9,5% të qytetarëve. Nëse merren parasysh të dhënat për numrin e anëtarëve nga sindikatat, të cilat kanë reprezentim të siguruar[1] (ECC, 2010), ky numër vërtetohet (27% të punësuarve ose 18% të popullatës aktive). Në kishat dhe bashkësitë fetare, edhe krahas asaj që gëzojnë besim më të lartë të qytetarëve (Klekovski etj. 2010), gjithashtu një pakicë e qytetarëve janë deklaruar se janë anëtarë të tyre.

Tabela VI 1. Besimi dhe anëtarësimi i qytetarëve në organizata të shoqërisë civile

	Kisha dhe bashkësi fetare	Sindikata	Parti politike	Organizata qytetare
Besim	62,9 %	25,3 %	23,3 %	42,5 %
Anëtarësim	30,7 %	24,2 %	37,5 %	24,6 %

Anëtarësimi në organizatat qytetare është i llojllojshëm, gjegjësisht marrin pjesë shumica e grupeve socio-demografike.

Tabela VI 2. Anëtarësim në organizata qytetare sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike

	Mashkull	Femër	Maqedonas etnik	Shqiptar etnik	Gjithsej
Anëtar aktiv	9,7	9,4	8,7 %	12,4 %	**9,5 %**
Anëtar joaktiv	17,2	13,0	11,6 %	28,2 %	**15,1 %**

Qytetarët më të rinj (prej 18 deri 29 vjet) më shumë janë anëtarë në organizata qytetare nga grupet tjera të moshave, derisa nëse merret parasysh anëtarësimi aktiv, atyre i bashkëngjiten edhe qytetarët e

[1] Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë (LSM) dhe Konfederata e Sindikatave të Lira të Maqedonisë (KSL)

moshës prej 40 deri 49 vjet. Lidhur me statusin e punës, veçohen studentët dhe të punësuarit në sektorin publik, të cilët më së shumti janë anëtarë në organizatat qytetare. Qytetarët me arsim më të lartë dhe ata të cilët ndjehen si pjesëtarë të klasave më të larta më shumë janë anëtarë në organizatat qytetare.

Tabela VI 3. Anëtarsëimi i qytetarëve në organizatat qytetare sipas arsimimit

	Arsim i papërfunduar fillor	Fillor	I mesëm	I lartë, sipëror	Gjithsej
Anëtar aktiv	4,5 %	3,2 %	8,9 %	14,1 %	**9,5 %**
Anëtar joaktiv	13,6 %	10,9 %	15,0 %	17,6 %	**15,1 %**

Tabela VI 4. Anëtarësimi i qytetarëve në organizatat qytetare sipas ndjenjës së përkatësisë ndaj një klase të caktuar

	Klasë e lartë	Klasë më e lartë e mesme	Klasë më e ulët e mesme	Klasë punëtore	Klasë më e ulët	Gjithsej
Anëtar aktiv	25,0 %	14,2 %	9,6 %	7,0 %	2,9 %	**9,5 %**
Anëtar joaktiv	29,2 %	18,8 %	18,3 %	11,0 %	5,8 %	**15,1 %**

Individualisht sipas sektorëve nuk ka ndryshime më të mëdha në anëtarësimin në organizatat qytetare, gjegjësisht më së paku qytetarë (4,6%) janë anëtarë në organizatat e konsumatorëve, ndërsa më së shumti (9,8%) në organizatat socio-humanitare. Ndryshim më i madh paraqitet vetëm te organizatat për sport, hobi dhe rikrijim, ku është zvogëluar anëtarësimi nga 12,8% në vitin 2009 në 8,2% në vitin 2010. Besimi në organizatat nga nën sektorët e dhënë nuk ka ndikim të madh mbi anëtarësimin, gjegjësisht nën sektoreët "personat me nevoja të veçanta" dhe "gratë dhe çështjet gjinore" janë të dytë, d.m.th. në vend të tretë sipas besimit, por në raport me anëtarësimin janë në pjesën e poshtme të tabelës.

Tabela VI 5. Anëtarësimi i qytetarëve në organizatat e shoqërisë civile sipas nënsektorëve

Nënsektorët e veprimit	Besimi	Anëtarësimi	Anëtarësimi
	2010		2009
Organizata sociale dhe humanitare	41,2 %	9,8 %	13,9 %
Fëmijë, të rinj dhe studentë	58,5 %	9,2 %	10,0 %
Mjedisi jetësor dhe natyra (organizatat ekologjike)	48,4 %	9,1 %	11,5 %
Demokracia, të drejtat e njeriut dhe sundimi i të drejtës	36,7 %	8,8 %	8,0 %
Kultura dhe arsimi	41,6 %	8,3 %	8,6 %
Sport, hobi dhe rekrijimi	47,5 %	8,2 %	12,8 %
Organizata profesionale	32,9 %	7,6 %	8,8 %
Gratë dhe çështjet gjinore	52,0 %	7,4 %	8,8 %
Personat me handikap	58,4 %	7,1 %	6,1 %
Shëndeti dhe shëndetësia	-	6,1 %	7,3 %
Zhvillimi rural	38,5 %	5,7 %	6,1 %
Organizatat e konsumatorëve	-	4,6 %	3,8 %

MËNYRA E INKUADRIMIT

Inkuadrimi në format e ndryshme të shoqërimit është hulumtuar nga aspekti i pagesës së anëtarësimit dhe punës vullnetare.

Grafiku VI 2. Pagesa e anëtarësimit në Forma të ndryshme të shoqërimit



Grafiku VI 3. Pagesa e anëtarësimit në organizatat qytetare



Pjesëmarrja në organizatat e shoqërisë civile përmes pagesës së anëtarësimit është stabile (27,5% në vitin 2010 dhe 27,1% në 2009). Në organizatat qytetare paguan anëtarësim një pakicë e parëndësishme (7,5%) që paraqet rënie të matur në raport me 2009. Anëtarësimi si burim i financimit paraqitet në 51,2% të organizatave qytetare, por i njëjti përbën më së shumti 5% të buxhetit të tyre (Stojanova D., 2010).

Pakicë e vogël e qytetarëve (12,6%) paguan anëtarësim në organizatat qytetare, dhe kjo është për gjysmë më pak nga ata që paguajnë anëtarësim për forma të ndryshme të shoqërimit.

Grafiku VI 4. Puna vullnetare në forma të ndryshme të shoqërimit



Në vitin 2010 qytetarët më së shumti vullnetarisht kanë punuar në kishat dhe bashkësitë fetare (13,4%). Puna vullnetare në këtë formë të shoqërimit shënon rritje të vogël, ndërsa në partitë politike, ku qytetarët më së shumti kanë qenë vullnetar në vitin 200o9, shënon rënie të vogël të matur. Puna vullnetare në sindikatat dhe organizatat qytetare është stabile. Edhe në vitin 2010 në ato kanë qenë vullnetar pakicë e parëndësishme e qytetarëve. Megjithatë shumica e qytetarëve (63%) nuk janë vullnetar në asnjë nga katër format e shoqërimit për të cilat ishin pyetur.

Dallimet e punës vullnetare mes nën sektorëve të veprimit në kuadër të organizatave qytetare janë të parëndësishme.

Grafiku VI 5. Koha e përkushtuar e punës vullnetare në organizatat qytetare



Koha e përkushtuar në punën vullnetare është zvogëluar dukshëm në raport me vitin 2009, kur 11% të qytetarëve kanë marrë pjesë me punë vullnetare me mbi 10 orë në muaj.

MOTIVIMI PËR INKUADRIM

Motivimi për inkuadrim të qytetarëve në aktivitetet e organizatave të shoqërisë civile nuk ka ndryshim në raport me vitin e kaluar.



Grafiku VI 6. Motivi për inkuadrim të qytetarëve në organizatat e shoqërisë civile

Në pyetjen pse organizatat ku janë anëtarë kanë rëndësi për ata, qytetarët, ngjashëm me vitin 2009, janë përgjigjur për shkak të socializimit, për shkak të pajtueshmërisë së tyre me

misionin e organizatës dhe për shkak të ndihmës në bashkësi. Ndryshim ka vetëm në radhitjen e motivimit, gjegjësisht të socializmit dhe ndihmës së bashkësisë i ndërruan vendet.

PËRFUNDIME

1. Pak qytetarë angazhohen në bashkësitë fetare, sindikatat, partitë politike dhe organizatat qytetare

Pakicë e qytetarëve anëtarësohen në çfarëdo forme të shoqërimit. Partitë politike janë më tërheqëse për qytetarët, gjegjësisht 37,5% prej tyre janë anëtarë në këtë lloj të shoqërimit. Pas tyre vijojnë kishat dhe bashkësitë fetare, ku 30,7% të qytetarëve janë deklaruar se anëtarësohen. Qytetarët më së paku janë anëtarë në sindikata (24,2%) dhe në organizatat qytetare (24,6%).

Shumicë e qytetarëve nuk punojnë vullnetarisht në asnjë formë të shoqërimit.

2. Pakicë e parëndësishme e qytetarëve janë aktiv dhe punojnë vullnetarisht në organizata qytetare

Inkuadrimi i qytetarëve në organizatat qytetare është i vogël (24,6% janë anëtarë) dhe nuk ka zhvendosje të mëdha në raport me vitet e kaluara. Pothuaj dy të tretat e anëtarëve të organizatave qytetare janë jo aktiv.

Vullnetarisht në organizatat qytetare punojnë 9% të qytetarëve, që përputhet me numrin e anëtarëve aktiv në atë (9,5%). Vëllimi i punës vullnetare është zvogëluar, në vitin 2009 11% të qytetarëve kanë qenë vullnetarë me mbi 10 orë në muaj përkundër 2,2% në vitin 2010.

3. Partitë politike mobilizojnë më shumë qytetarë dhe m pak besim në krahasim me format tjera të shoqërimit

Partitë politike gëzojnë më pak besim nga qytetarët (23,3%), se sa format tjera të shoqërimit, e megjithatë mobilizojnë më shumë qytetarë prej tyre.

Në çdo pesë qytetarë, dy janë anëtarë të ndonjë partie politike, por megjithatë vetëm një është aktiv. Përveç anëtarësimit, partitë politike mobilizojnë edhe më shumë qytetarë për punë vullnetare, se sa organizatat qytetar5e, kishat dhe bashkësitë fetare dhe sindikatat.

4. Socializimi, ndihma e bashkësisë dhe pajtueshmëria me misionin janë motivet për punë vullnetare në organizatat qytetare

Një e treta e qytetarëve të cilët punojnë vullnetarisht në organizatat qytetare e bëjnë këtë për shkak të socializimit. Kontributi ndaj bashkësisë dhe besimi në misionet e organizatave për të cilat punojnë vullnetarisht janë gjithashtu motiv i rëndësishëm për qytetarët.

VII KONTRIBUTET BAMIRËSE

Kontributet bamirëse janë hulumtuar përmes 17 pyetjeve. Një pjesë të përgjigjeve mund ti krahasonim me hulumtimin për dhurimin bamirës nga viti 2009. Rezultatet tregojnë cilat janë shprehitë për dhurim bamirës të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË KONTRIBUTE BAMIRËSE



Grafiku VII 1. Dhurimi i kontributeve bamirëse në 12 muajt e kaluar

Ka rënë numri i atyre që kanë dhuruar në 12 muajt e fundit, prej 70,9% në vitin 2009, në 65,2% në vitin 2010. Pak

është rritur përqindja e dhuruesve të rregullt, për 1,2 pikë përqindjes dhe përqindja e dhuruesve potencial, për 4,8 pikë përqindjes. Karakteristikat socio-demografike kanë ndikim në dhurimin e qytetarëve. Përqindja e atyre të cilët kanë dhuruar rritet nga klasa më e ulët (42,2%) drejt klasës më të lartë (91,7%) dhe me shkallën e arsimimit prej atyre me shkollim të papërfunduar fillor (27,3%) deri te ata me arsimim të lartë dhe sipëror (70,8%). Kjo mund të vërehet lidhur me të ardhurat mujore në amvisëri, rritet dhurimi prej atyre me të ardhura mes 1.500 dhe 3.000 denarë (51,3%), drejt atyre me mbi 24.000 (78,2%). Përjashtim bëjnë ata me të ardhura më të ulëta, deri 1.500 denarë, ku dhurimi është 72,7%. Sipas veprimtarive, të punësuarit në sektorin publik dhurojnë më së shumti (73,3%), ndërsa bujqit (55,6%) më së paku. Simpatizuesit e PDSH (84,7%) dhe BDI (76,1%) dhurojnë më shumë nga simpatizuesit e LSDM (62,5%) dhe VMRO-DPMNE (61,8%). Në pikëpamje të vendit të banimit, banorët e rajonit Lindor dhurojnë më së shumti (74,5%), ndërsa ata të rajonit Juglindor (42,6%) më së paku.

MOTIVIMI

Shkaqet për dhurim, ose motivimi, në këtë hulumtim u hulumtuan nëpërmjet pyetjeve të veçanta, për dallim nga hulumtimi paraprak kur të anketuarit mund të zgjidhnin një nga përgjigjet në kuadër të pyetjes së vetme për motivimin gjatë dhurimit. Kjo është e mundshme të bëjë me rritjen në të gjitha përgjigjet lidhur me hulumtimin në vitin 2009. Shumica e të anketuarve dhurojnë për shkak të përgjegjësisë morale, gjegjësisht sepse mendojnë se njerëzit duhet të mbështeten mes veti. Për 12,1 pikë përqindjes është rritur numri i atyre të cilët e kanë cekur motivimin për të dhuruar. Ky numër rritet nga ata të klasës më të ulët (39,4%), drejt atyre të klasës më të lartë (91,7%) dhe ata me arsimim të papërfunduar fillor (22,7%), drejt atyre me arsimim të lartë ose sipëror (67,1%). Shumica nga mesatarja, këtë e kanë cekur si motiv ata me të ardhura prej mbi 24.000 denarë (74,8%), simpatizuesit e PDSH (83,1%) dhe banorët e rajonit Lindor (74,5%).

Pakicë e të ankoruarve kanë vendosur për motivet tjera për të dhuruar. **Nga keqardhja** dhurojnë 49,2%. Mund të vërehet rritje e keqardhjes varësisht nga mosha e të anketuarve, prej 45,7% te ata mes 18 dhe 29 vjet, deri 54% te ata me mbi 65 vjet dhe varësisht nga arsimimi prej 9,1% te ata me arsimim të papërfunduar fillor, deri 52,4% te ata me arsimim të lartë ose sipëror. Më shpesh këtë motiv e kanë zgjedhur edhe ata të klasës më të lartë (70,8%), të punësuarit në sektorin publik (57,2%) dhe pensionistët (57%), banorët e Shkupit (57,7%), ata me të ardhura deri 1.500 denarë (66,7%) dhe banorët e rajonit Lindor (70,6%), të Vardarit (64,3%) dhe të Pellagonisë (61,6%). Dallimet ekzistojnë edhe mes maqedonasve etnik (53,6%) dhe shqiptarët etnik (35,5%), si edhe te ortodoksët (54,5%) dhe ata mysliman (38%). Mes simpatizuesve të partive politike, ky motiv më poshtë është radhitur te ata të PDSH-së (39%).

Grafiku VII 2. Motivimi



Motivimin e vet për dhurim (40,8%) nga të anketuarit e përshkruajnë si **interes i shoqërisë.** Edhe këtu mund të vërehet ndikimi i

arsimit, përqindja rritet nga ata me arsimim të papërfunduar (18,2%), drejt atyre me arsim të lartë ose sipëror (45,1%). Për shqiptarët etnik ky ka qenë motivim më i madh për dhurim, se sa, siç pamë më sipër, keqardhja. Për shumicë prej tyre (50,6%), ky është motivi për dhurim, përkundër 36,9% nga maqedonasit etnik. Dallimi i këtillë vërehet edhe mes pjesëtarëve të religjionit islam (50%) dhe ata të krishterimit ortodoks (36,3%). Dallimi mund të vërehet edhe mes simpatizuesve të PDSH (54,2%) dhe BDI (53,7%) nga njëra anë dhe ata të VMRO-DPMNE (37,4%) dhe të LSDM (34%) nga ana tjetër. Në pikëpamje të vendit të banimit, ky motiv më shpesh i orienton ata të rajoni Lindor (69,6%) dhe ata të rajonit të Vardarit (58,6%).

Kam dhe mund të jap si motiv i shpie 29,6% të anketuarve. Rritet numri i përgjigjeve pozitive të klasës më të ulët (16,3%) drejt asaj më të lartë (58,3%) dhe ata me arsimim të papërfunduar fillor (0%) drejt atyre me arsimim të lartë ose sipëror (35,1%). Më shpesh nga mesatarja këtë e zgjedhin si motiv ata me të ardhura me mbi 24.000 denarë (41,2%) dhe banorët e rajonit lindor (42,2%). Edhe pse një pakicë, 22,6% të qytetarëve dhurojnë sepse dëshirojnë **të bëjnë diçka për kthim.** Nuk ka dallime të mëdha socio-demografike nga vlera mesatare përveç të bujqit (40,7%) dhe banorët e rajonit Lindor (51%), rajonit të Vardarit dhe Verilindor (40%). Edhe këtu arsimimi luan rol në përgjigjet, e kështu përgjigjet pozitive rriten prej 4,5% te ata me arsimim të papërfunduar fillor, deri 24,5% te ata me arsimim të lartë ose sipëror.

Pasiqë e kanë **pasur të pakëndshme të refuzojnë**, kanë dhuruar 22,2% të anketuarve. Më të larta janë përqindjet te bujqit (33,3%) dhe amviset (32,3%), pjesëtarët e klasës më të lartë (45,8%), ata me të ardhura prej 1.500 denarë (56,1%), simpatizuesit e BDI (35,8%) dhe banorët e rajonit të Pellagonisë (35,7%) dhe Lindor (31,4%). Pakicë e vogël e të anketuarve (10,9%) **dhurojnë që të lirohen nga ata që kërkojnë me këmbëngulje.** Përgjigje e këtillë gjendet te bujqit (22,2%), ata me të ardhura deri 1.500 denarë (21,2%), simpatizuesit e PDSH (20,3%) dhe banorët e rajonit Lindor (23,5%). Edhe motivi i fundit i hulumtuar, për shkak të interesit personal, ka mbështetje më të vogël në përgjigjet, 4,2%. Më shumë se mesatarja, pozitivisht janë përgjigjur bujqit (14,8%) dhe simpatizuesit e PDSJ (15,3%).

Shkaqet për të mos dhuruar, te ata 34,9% të anketuarve të cilët nuk kanë dhuruar në 12 muajt e kaluar, janë disa. Më shpesh të zgjedhurat janë dëshiroj, por nuk di si (13,1%) dhe secili duhet të kujdeset për veten (13%). Pothuaj edhe të mos ketë dallime socio-demografike për mos informimin se si dhurohet. Veçohen vetëm ata të klasës më të ulët 920,2%), ata me të ardhura mes 4.000 dhe 5.000 denarë (21,7%) dhe banorët e rajonit juglindor (24,5%). Te shkaku i dytë, mund të vërehet ndikimi i arsimimit në përgjigjet, e kështu përqindja e atyre që mendojnë se secili duhet të kujdeset për veten rritet prej 10,7% te ata me arsim të lartë ose sipëror, deri 36,4% te ata me arsimim të papërfunduar fillor. Rritje e këtillë vërehet edhe në klasat, dhe atë prej 0% në klasën më të lartë, deri 26,9% te ata të klasës më të ulët. Më shumë se mesatarja ky qëndrim është potencuar edhe te ata me të ardhura mesatare mes 3.000 dhe 4.000 denarë.

Grafiku VII 3. Shkaqet për mos dhurim të kontributeve bamirëse



Nuk besojnë në sukses 11,2% të anketuarve dhe prandaj nuk dhurojnë. Më me pak besim janë ata të klasës më të ulët, përqindja bie nga ata (22,1%), drejt atyre të klasës më të lartë 0%. Më me pak besim në sukses janë edhe ata me arsimim të papërfunduar fillor (31,8%), ndërsa besimi rritet drejt atyre me arsimim të lartë ose sipëror (9,4%). Sipas vendit të banimit, më pak besim në suksesin e kontributeve bamirëse besojnë banorët e rajonit Jugperëndimor (21,3%). Pakicë e vogël (9,2%) dyshojnë në keqpërdorimin e kontributeve bamirëse. Nuk ka anime të dukshme nga mesatarja të cilat kanë të bëjnë me karakteristikat socio-demografike të anketuarve. Përqindje e ngjashme (9,1%) nuk dhurojnë sepse nuk kanë mjaft për vete. Këtu mund të vërehet ndikimi i arsimimit mbi përgjigjet. Përgjigjet pozitive janë rritur prej 5,3% te ata me arsimim të lartë ose sipëror, deri 27,2% te ata me arsimim të papërfunduar fillor. Rriten edhe nga klasa më e lartë (0%) drejt më të ulëtës (20,2%). Më të shprehura janë këto përgjigje edhe te ata me të ardhura mujore mes 4.000 denarë dhe 5.000 denarë (17%), gjegjësisht ata mes 3.000 dhe 4.000 denarë (18,4%) dhe banorët e rajonit jugperëndimor (18,1%).

QËLLIMET E KONTRIBUTEVE BAMIRËSE

Qytetarët më shpesh kanë dhuruar për shëndet dhe ndihmë të sëmurëve (20,6%). Ky qëllim është në rritje të vogël në raport me hulumtimin nga viti 2009 kur kanë dhuruar 18,3%. Qëllimet humanitare dhe dhurimi për të varfrit është në rënie të vogël në raport me vitin 2009 për 4,1 gjegjësisht për 2,8 pikë përqindjes. Maqedonasit etnik (24,7%) dhe ortodoksët (25%) dhurojnë më shumë për shërim, ndërsa shqiptarët etnik (24,7%) dhe pjesëtarët e islamit (19,9%) për ndihmë humanitare. Nga aspekti i statusit të punës, ja si janë prioritetet: të punësuarit në sektorin publik më shpesh dhurojnë për shërim (25,7%), si edhe nga sektori privat (22,9%), bujqit për kisha ose xhamia (14,8%), ndërsa studentët për ndihmë humanitare (22%), si edhe amviset (20%). Të punësuarit (16%) dhe pensionistët (25%) prioritet e kanë shërimin. Për shërim më së shumti dhurojnë në rajonin e Shkupit (31,5%), ndërsa për qëllime humanitare rajoni Verilindor (26,7%).

Grafiku VII 4. Qëllimi i dhurimit në vitin 2010



Në pyetjen çfarë e kanë për pritet për të dhuruar, asnjë nga fushat nuk ka mbështetje të shumicës nga të anketuarit. Më së shpeshti është zgjedhur shëndeti dhe shëndetësia, e pastaj vijojnë mbështetja humanitare, personat me nevoja të veçanta etj. Mosha ka ndikim te dhurimi për kishat dhe bashkësitë fetare. Mbështetja rritet prej 7,4% te ata prej moshës 18 deri 29 vjet, deri 15% te ata mbi 65 vjet. Kjo mund të vërehet edhe te shëndeti dhe shëndetësia, linja e rritjes është e ngjashme, nga 13,4% deri 20,4%. Tre prioritetet e maqedonasve etnik, sipas deklaratave të anketuarve janë: shëndeti dhe shëndetësia (21,5%), ndihma humanitare (11,7%) dhe kishat dhe bashkësitë fetare (11,1%). Te shqiptarët etnik këto janë: kishat dhe bashkësitë fetare (15,8%), fëmijët, të rinjtë dhe studentët (14,7%) dhe personat me nevoja të veçanta (10%). Shëndeti dhe shëndetësia janë fushat më me prioritet për çdo nga statuset e punës të hulumtuara, përveç për bujqit dhe amviset për të cilët kishat dhe bashkësitë fetare kanë më shumë prioritet. Ata të cilët veten e përshkruajnë si klasë e lartë, për më prioritare e llogarisin shëndetin dhe shëndetësinë dhe fëmijët, të rinjtë dhe studentët (29,2%), ndërsa ata të klasës më të ulët, kishat dhe bashkësitë fetare (17,3%). Shëndeti dhe shëndetësia është më prioritare për ata me arsimim të mesëm (17,4%) dhe ata me arsimim të lartë ose sipëror (18,8%), ndërsa kishat dhe bashkësitë fetare për ata me arsimim të përfunduar fillor (17,9%) dhe ata me arsimim të papërfunduar fillor (13,6%). Nga aspekti i të ardhurave mujore, më shumë grupe prioritet i japin shëndetit dhe shëndetësisë me përjashtim të atyre me të ardhura deri 1.500 denarë (31,8%) dhe ata mes 3.000 dhe 4.000 denarë (14,9%) për të cilët prioritet e kanë kishën dhe bashkësitë fetare dhe ata me të ardhura mes 1.500 denarë dhe 3.000 denarë (17,6%) dhe ata ames 15.000 dhe 24.000 denarë (19,1%) për të cilët prioritet është ndihma

humanitare. Prioritet për simpatizuesit e VMRO-DPMNE (22,6%) dhe LSDM (16,7%) është shëndeti dhe shëndetësia, të BDI (22,4%) janë kishat dhe bashkësitë fetare, ndërsa për të PDSH (22%) fëmijët, të rinjtë dhe studentët. Banorët e rajonit Lindor (36,3%), të Shkupit (24,7%) dhe Juglindor (24,5%) për prioritet e llogarisin shëndetin dhe shëndetësinë, ata të Vardarit (45%) ndihmën humanitare, të Pellagonisë (33%) kishat dhe bashkësitë fetare, Verilindor (17,8%) fëmijët, të rinjtë dhe studentët, ndërsa të Pollogut (16,1%) personat me nevoja të veçanta.

Tabela VII 1. Fushat prioritare për dhurim

Fusha	2010	2009
Shëndeti she shëndetësia	17,5 %	18,3 %
Kujdesi social (humanitar)	14,9 %	22,9 %
Personat me nevoja të veçanta	12,4 %	6,3 %
Kishat dhe bashkësitë fetare	11,5 %	18,5 %
Fëmijët, të rinjtë dhe studentët	10,0 %	7,1 %
Mjedisi jetësor dhe natyra	1,9 %	1,5 %
Demokracia, të drejtat e njeriut dhe sundimi i të drejtës, anti korrupsioni	1,8 %	2,2 %
Kultura, arti dhe arsimi	1,5 %	1,1 %
Partitë politike	1,3 %	0,9 %
Gratë dhe çështjet gjinore	1,2 %	1,3 %
Zhvillimi rural	1,1 %	0,9 %
Sport, hobi dhe rekrijim	1,1 %	1,1 %
Organizata profesionale	0,3 %	0,1 %
Sindikatat	0,1 %	0,1 %

Në rënie janë nivelet për dhurim të cilat janë më të afërta deri te të anketuarit. Dhurimi lokal, në bashkësinë lokale, si nivel prioritar është për 17,5% të anketuarve dhe kjo është rënie për 15 pikë përqindjes në raport me hulumtimin në vitin 2009. Për 9 pikë përqindjes është në rënie komuna si nivel prioritar i dhurimit.

Grafiku VII 5. Nivelet prioritare të dhurimit



Në linjë të drejtë rritet interesimi për nivelin nacional si prioritare nga ato të klasës më të ulët (7,7%), drejt atyre të klasës më të lartë (25%), si edhe nga ata me arsimim të papërfunduar fillor (9,1%). Sipas vendit të banimit, vërehet rritje e nivelit varësisht nga madhësia e vendit të banimit. Ata të cilët jetojnë në mjedise rurale (23,6%), ata nga mjediset urbane (30,5%), komunën, ndërsa ata të cilët jetojnë në Shkup (32,9%) nivelin nacional. Për simpatizuesit e BDI (37,3%) dhe PDSH (33,9%) nivel më prioritar është ai komunal. Sa i përket rajoneve, niveli lokal është më prioritar për banorët e rajonit të Pollogut (27,8%), ai komunal për banorët e rajonit Verilindor (38,9%), i Vardarit (34,3%), i Pellagonisë (33,9%) dhe Lindor (33,3%), ndërsa niveli nacional për rajonin e Shkupit (31,5%).

PËRFUNDIME

1. Ka rënë numri i atyre të cilët kanë dhuruar në 12 muajt e fundit prej 70,9% në vitin 2009, në 65,2% në vitin 2010

Ndaj dhurimit ndikojnë arsimimi, perceptimi i njerëzve për atë se cilës klasë i takojnë dhe të ardhurat mujore në amvisëri. Përqindja rritet prej atyre me arsimim të papërfunduar fillor (27,3%), deri te ata me arsimim të lartë ose sipëror (70,8%), nga klasa më e ulët (42,2%) drejt klasës më të lartë (91,7%) dhe ata me të ardhura mes 1.500 dhe 3.000 denarë (51,3%), deri te ata me mbi 24.000 (78,2%). Te të ardhurat mujore përjashtim bëjnë ata me të ardhura më të ulëta, deri 1.500 denarë, ku dhurimi është 72,7%.

2. Motivimi për dhurim më shpesh është solidariteti

Solidariteti si motiv është rritur në raport me hulumtimin paraprak në vitin 2009 për 12,1 pikë përqindjes. Ndikimi i arsimimit dhe të klasave mund të vërehet edhe këtu. Numri i qytetarëve të këtillë të motivuar rritet nga at me arsimim të papërfunduar fillor (22,7%), drejt atyre me arsimim të lartë ose sipëror (67,1%) dhe nga ata të klasës më të ulët (39,4%) drejt atyre të klasës më të lartë (91,7%).

3. Prioritet për dhurim është shëndeti dhe shëndetësia

Përveç që në 12 muajt e kaluar më së shumti kanë dhuruar për shëndet dhe ndihmë të sëmurëve 920,6%), numri më i madh i të anketuarve shëndetin dhe shëndetësinë e kanë cekur edhe si fushë prioritare për dhurim (17,5%). Mosha ndikon gjatë dhurimit për këtë fushë prioritare, që rritet nga 7,4% te ata prej moshës 18 deri 29 vjet, deri 15% te ata mbi 65 vjet. Në vend të dytë janë qëllimet humanitare me 14,2% në vitin paraprak dhe 14,9% si fushë prioritare për dhurim. Demokracia, të drejtat e njeriut dhe sundimi i të drejtës, anti korrupsioni (1,8%) dhe kultura, arti dhe arsimimi (1,5%) ende janë në fund të listës së prioriteteve te qytetarët.

4. Komuna ia merr primatin bashkësisë lokale si nivel prioritar i dhurimit

Edhe pse të dy nivelet janë në rënie, për shkak të rënies së dhurimit në vitin 2010, këtë vit ka dallime të qarta mes komunës (23,1%) dhe bashkësisë lokale (17,5%) si nivele prioritare për dhurim. Niveli nacional mbetet në korniza të njëjta si në vitin 2009. Arsimimi, përkatësia ndaj klasave të caktuara dhe vendi i banimit ndikojnë në përgjigjet. Interesimi i nivelit nacional rritet nga 9,1% te ata të klasës më të ulët, deri 25% te ata të klasës më të lartë. Nivele prioritare janë adekuate me madhësinë e vendit të banimit. Lokalja është prioritet për ata të cilët jetojnë në mjedise rurale (23,6%), komunale për ata nga mjediset urbane (30,5%), ndërsa nacionale për ata të cilët jetojnë në Shkup (32,9%).

VIII PËRGJEGJËSIA PËR MJEDISIN JETËSOR

Përgjegjësia ndaj mjedisit jetësor nga ana e shtetit, ndërmarrjeve dhe qytetarëve bëhet çështje shumë prezent në botë, por edhe në opinionin maqedonas. Përgjegjësia e qytetarëve ndaj mjedisit jetësor për herë të parë u mat në vitin 2009 edhe krahas aspekteve tjera që i përfshin edhe përgjegjësinë ligjore dhe morale të qytetarëve ndaj mjedisit jetësor. Në këtë drejtim, në kuadër të këtij hulumtimi të qytetarëve u parashtruan nëntë pyetje për qëndrimet e tyre për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Pyetjet kishin të bëjnë me disa standarde për mbrojtjen e mjedisit jetësor, masat për mbrojtjen e ajrit dhe natyrës, si edhe për menaxhimin me mbeturinat e forta.

Grafiku VIII 1. Pajtueshmëri për rritjen e tatimeve, nëse mjetet shfrytëzohen për pengimin e ndotjes së mjedisit



Qytetarët pajtohen se kanë përgjegjësi për ruajtjen e mjedisit jetësor (92,4%). Në vijim, shumica (prej 89,5% deri 52,8%) qytetarët pajtohen me të gjitha masat dhe aktivitetet për të cilat ishin pyetur. Pajtueshmëri më të madhe jepet për dënime të rrepta/larta për hedhjen e mbeturinave në vende që nuk janë caktuar për këtë qëllim dhe të deponive të egra (89,5%), ndërsa pajtueshmëri më të ulët për rritjen e tatimeve për shkak të pengimit të ndotjes (52,8%).

Lidhur me këtë pyetje paraqiten dallime më të vogla në nivelin e pajtueshmërisë varësisht nga përkatësia etnike, dhe më të mëdha varësisht nga niveli i arsimimit, rajonit, statusit të punës dhe vetëperceptimit për statusin social.

Grafiku VIII 2. Pajtueshmëri për vendosjen ose rritjen për mbrojtjen e mjedisit jetësor



Një nga masat me të cilat qytetarët më së shumti pajtohen (81,4%) është ndalesa për punën e fabrikave-ndotëse, derisa nuk i plotësojnë standardet ekologjike.

Për masë të ngjashme, kësaj radhe për vendosjen e afatit për përjashtim të automjeteve të udhëtarëve derisa nuk i plotësojnë standardet ekologjike, qytetarët më pak pajtohen (75%).

Shumicë e madhe e qytetarëve pajtohen edhe me ngritjen e standardeve për ndërtim për shkak të kursimit të energjisë (79,3%).

Profili i qytetarëve të cilët pajtohen me vendosjen ose rritjen e standardeve për mbrojtjen e mjedisit jetësor është relativisht homogjene. Karakteristikat të cilat kanë ndikim të madh në qëndrimet janë niveli i arsimimit dhe rajoni, si edhe statusi i punës dhe vetëperceptimi për statusin social. Amviset dhe bujqit shprehin pajtueshmëri më të vogël për tre masat se sa qytetarët e tjerë. Pajtueshmëria rritet siç rritet niveli i arsimimit dhe statusi social. Më të mëdha janë dallimet lidhur me vendosjen e afatit përjashtim të automjeteve të udhëtarëve të cilët nuk i plotësojnë standardet ekologjike.

Tabela VIII 1. Ndikimi i nivelit të arsimimit mbi pajtueshmërinë për masat e caktuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor

Arsimimi / Qëndrimi	Shkollim fill. i papërfunduar	Fillor	Mesëm	Lart ose sipëror	Gjithsej
Ndalesë për punën e fabrikave të cilat ndotin	59,1 %	76,3 %	79,6 %	88,7 %	**81,4 %**
Ngritja e vetëdijes për efikasitet energjetik	54,5 %	70,5 %	79,4 %	85,3 %	**79,3 %**
Përjashtimi i automjeteve të udhëtarëve	36,4 %	72,4 %	74,0 %	80,9 %	**75,0 %**

Rajoni ku jetojnë qytetarët ka ndikim mbi të gjitha qëndrimet për plotësimin e standardeve për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Në disa rajone më e shprehur është pajtueshmëria e lartë për ndonjërën nga masat. Kështu në rajonin e Vardarit 98,6% të qytetarëve pajtohen me ndalesën për punë të fabrikave-ndotëse)prej të cilave 87,1% plotësisht pajtohen) dhe nuk ka qytetarë i cili aspak nuk pajtohet me këtë masë. Në të vërtetë kjo është pajtueshmëria më e lartë e cila është dhënë për ndonjërën nga masat nga cili do qoftë grup socio-demografik. Pajtueshmëri të qytetarëve të cilët jetojnë në Shkup edhe në rajonin e Shkupit është më e lartë nga pajtueshmëria në pjesën më të madhe të tjerëve për të gjitha masat. Gjithashtu edhe mbështetja nga rajoni i Vardarit është mbi pajtueshmërinë në nivel nacional për të gjitha tre masat.

Tabela VIII 2. Ndikimi i rajonit mbi pajtueshmërinë për masë të caktuar për mbrojtjen e mjedisit jetësor

Rajoni / Qëndrimi	I Shkupit	Jugli-ndor	Lindor	Veri-lindor	I Vardarit	Jugperë-ndimor	I Pollogut	I Pella-gonisë	Gjithsej
Ndalesë për punën e fabrikave të cilat ndotin	88,0	55,3	84,1	80,0	98,6	75,5	76,7	76,8	**81,4**
Ngritja e standardeve për efikasitet energjetik	89,6	67,0	91,2	60,0	88,6	80,9	66,1	80,4	**79,3**
Përjashtimi i automjeteve të udhëtarëve	84,4	56,4	81,4	58,9	82,9	71,3	72,8	74,1	**75,0**

Qytetarët u pyetën edhe për masat konkrete dhe aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin me mbeturinat e fuqishme, siç janë: seleksionimi i obliguar i mbeturinave nga amvisëritë për shkak të riciklimit të tyre, dënimet e rrepta/të larta për hedhjen e mbeturinave në vende që nuk janë caktuar për këtë, ndalesa e përdorimit të qeseve plastike dhe zëvendësimi i tyre me ato të letrës ose pëlhurës dhe pagesa për ambalazh.

Grafiku VIII 3. Pajtueshmëri për masat për mbrojtjen e mjedisit jetësor nga ndotja me mbeturina të forta



Qytetarët më së shumti pajtohen me dënimet e larta për hedhjen e mbeturinave në vende që nuk janë caktuar për këtë (89,5%), ndërsa më pak pajtohen (59,6%) për pagesën për ambalazh, ngjashëm si edhe në vitin 2009.

Masat me të cilat qytetarët më së shumti pajtohen, dënimet e rrepta/të larta për hedhjen e mbeturinave në vende që nuk janë caktuar për këtë, gëzon edhe mbështetje homogjene. Këtu ndikim ka vetëm niveli i arsimimit, njëlloj si edhe për masat tjera, pajtueshmëria rritet me nivelin e

arsimimit. Kështu, për këtë masë pajtueshmëri japin 63,6% të qytetarëve me arsimim të papërfunduar fillor, 84,0% ata me arsimim fillor, 88,8% të qytetarëve me shkollim të mesëm dhe 95,3% ata me arsimim të lartë/sipëror.

Pjesa më e madhe nga karakteristikat socio-demografike, e para së gjithash gjinia nuk kanë ndikim mbi qëndrimet lidhur me masat për pengimin e ndotjes me mbeturina të forta.

Por, si edhe për ato parapraket, kështu edhe për këto masa, rajoni, arsimimi dhe pjesërisht statusi i punës dhe vetëperceptimi i statusit social kanë ndikim mbi qëndrimet e qytetarëve. Vetëm lidhur me statusin social ka ndryshime, gjegjësisht qytetarët të cilët mendojnë se i takojnë klasës më të lartë dhe të ulët, më pak pajtohen me masat nga ata të cilët mendojnë se i takojnë klasës së mesme të lartë ose klasës punëtore. Pajtueshmëri për masat rritet me nivelin e shkollimit, ndërsa më i dukshëm është ndikimi te pagesa për ambalazhin nga material që vështirë tretet (arsimim i papërfunduar fillor: 27,3%; fillor: 50,0%; të mesëm: 60,4%; të lartë/sipëror: 65,2%). Amviset dhe bujqit më pak pajtohen me masat nga qytetarët tjerë. Në rajonet pajtueshmëria ndryshon varësisht nga masat, kështu për disa masa disa rajone japin mbështetje më të lartë, a për disa më të ulëta nga të tjerët. Rajoni më interesant nga ky aspekt është ai Lindor, ky qytetarët japin pajtueshmëri më të lartë në krahasim me rajonet tjera për seleksionimin e obligueshëm dhe për riciklimin e mbeturinave (92,2%), ndërsa më të ulët për pagesën e ambalazhit (34,3%). Vetëm rajoni i Shkupit ka pajtueshmëri më të lartë nga pajtueshmëria në nivel nacional për të gjitha katër masat.

Tabela VIII 3. Ndikimi i statusit të punës mbi arsyetimin e masave të caktuara për mbrojtjen e ambientit jetësor nga ndotja me mbeturina të forta

Rajoni / Qëndrimi	I Shkupit	Jugli-ndor	Lindor	Veri-lindor	I Vardarit	Jugperë-ndimor	I Pollogut	I Pella-gonisë	Gjithsej
Dënime të larta për hedhjen e mbeturinave në deponi jolegale	92,2	85,1	81,2	83,3	90,0	89,4	87,2	92,9	**89,5**
Seleksionimi i obligueshëm i mbeturinave dhe riciklimi	87,0	88,3	92,2	78,9	80,0	76,6	78,9	88,4	**84,3**
Ndalesa e qeseve të plastikës	80,2	87,2	85,3	81,1	75,7	68,1	75,0	68,8	**77,9**
Pagesa e kaucionit të ambalazhit	61,4	72,3	34,3	66,7	72,9	56,4	64,4	48,2	**59,6**

Grafiku VIII 5. Pajtueshmëri për ndalesën e gjuetisë së kafshëve të egra



Shumicë e madhe e qytetarëve pajtohen edhe me ndalesën e gjuetisë së kafshëve të egra, që ndikon në zvogëlimin e llojllojshmërisë biologjike.

Pajtueshmëria për ndalesën e gjuetisë së kafshëve të egra është ndarë te pjesa më e madhe e grupeve të ndryshme të qytetarëve. Vetëm dallim më i madh paraqitet te bujqit (63,0%) dhe qytetarët me arsim fillor (64,1%) dhe atyre të cilët mendojnë se i takojnë klasës më të ulët (61,5%), si edhe te qytetarët nga rajoni Lindor (65,7 %).

PËRFUNDIME

1. Pajtueshmëri e lartë për përgjegjësinë e qytetarëve për ruajtjen e mjedisit jetësor

Shumicë e madhe e qytetarëve (92,4%) mendojnë se janë përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe japin mbështetje të madhe për masat për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

2. Mbështetje për standardet dhe masat për mbrojtje të mjedisit jetësor

Shumicë e madhe e qytetarëve pajtohen se duhet: të caktohet afat për përjashtimin e automjeteve të udhëtarëve të cilat nuk i plotësojnë standardet për gazrat që emetohen (75,0%); **të ndalohet puna e fabrikave-ndotëse, derisa nuk i plotësojnë standardet ekologjike (81,4%);** dhe të ngrihen standardet për ndërtim për shkak të kursimit të energjisë (79,3%).

Pajtueshmëri më lartë, në krahasim edhe me të gjitha masat tjera për të cilat u pyet, ka për ndalesën për punë të fabrikave-ndotëse te qytetarët e rajonit të Vardarit (98,6%). Në të njëjtë kohë, nuk ka qytetar nga ky rajon që aspak nuk pajtohet me ndalesën për punë të fabrikave të cilat nuk i plotësojë standardet ekologjike.

3. Mbështetje për riciklimin dhe menaxhimin me mbeturinat e forta

Mbështetja më e lartë (89,5%) dhe më homogjene, qytetarët i japin dënimeve të rrepta/të larta për hedhjen e mbeturinave në vende që nuk janë caktuar për këtë/deponitë jolegale.

Shumicë e madhe pajtohet edhe me **seleksionimin e obligueshëm të mbeturinave nga amvisëritë për shkak të riciklimit** (84,3%).

Shumicë e madhe e qytetarëve (77,9%) japin pajtueshmëri edhe me ndalesën e përdorimit të qeseve plastike dhe zëvendësimin e tyre me ato të letrës dhe pëlhurës. **Mbështetja është më e vogël për pagesën e kaucionit për ambalazh** që e ndot mjedisin jetësor (p.sh. shishet e plastikës), por megjithatë shumicë e qytetarëve (59,6%) pajtohet edhe me këtë masë.

4. Për mbrojtjen e llojllojshmërisë biologjike me pajtueshmëri për ndalesë të gjuetisë së kafshëve të egra

Shumica e qytetarëve (76,3%) pajtohen **që të ndalohet gjuetia e kafshëve të egra,** që ndikon në zvogëlimin e llojllojshmërisë biologjike, e ndonjëherë edhe të humbjes së disa llojeve të kafshëve.

5. Niveli i arsimimit, statusi i punës dhe vetëperceptimi për statusin social, si edhe rajoni ndikojnë në pajtueshmërinë lidhur me masat për mbrojtjen e mjedisit jetësor

Pajtueshmëria për masat për mbrojtjen edhe ruajtjen e mjedisit jetësor rritet me nivelin e arsimimit. Për pjesën më të madhe të masave qytetarët me arsimim më të lartë dhe të cilët llogariten se i takojnë klasave më të larta sociale japin mbështetje më të lartë. Pajtueshmëria me masat ndryshon në rajonet. Mund të veçohet rajoni i Shkupit ku qytetarët pothuaj për të gjitha masat japin mbështetje më të lartë nga ajo në nivel nacional. Në rajonet tjera për masat e ndryshme edhe pajtueshmëria është e ndryshme.

Shtojcë. Pyetësori

I. Përgjegjësia për çështjet shoqërore (në përgjithësi)

P1. Disa njerëz ndjejnë se kanë zgjidhje dhe kontroll plotësisht të lirë mbi jetën e tyre, ndërsa të tjerët ndjejnë se atë që e bëjnë, nuk ka kurrfarë ndikimi mbi atë që u ndodh. Në shkallën prej 1 deri 10, ju lusim ta vlerësoni sa liri për zgjidhje dhe kontroll mendoni se keni mbi jetën tuaj?

Kam kontroll mbi jetën time	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Nuk kam kontroll mbi jetën time

P2. Kush është përgjegjës për zgjidhjen e nevojave në shoqëri?
1 - Shteti
2 – Sektori privat (biznesi)
3 – Qytetarët (individualisht dhe/ose të organizuar në organizata qytetare)
4 – Përgjegjësia është e përbashkët/e ndarë
5 – Nuk kam qëndrim
6 – Nuk e di (spontanisht) / Pa përgjigje (spontanisht)

P3. Në këtë kartelë shihni qëndrime të kundërta për çështje të ndryshme shoqërore. Si do ti kishit caktuar qëndrimet tuaja në këtë shkallë? Cilin nga dy qëndrimet e keni më të afërt?

Njerëzit duhet të ndërmarrin më shumë përgjegjësi për kujdesin rreth vetes.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Shteti duhet të ndërmarr përgjegjësi më të madhe që secili ta ketë atë që i nevojitet.
Shteti duhet ti japë më shumë liri ndërmarrjeve.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Shteti duhet në mënyrë më efektive ti kontrollojë ndërmarrjet.
Duhet të rritet pronësia private e ndërmarrjeve.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Duhet të rritet pronësia shtetërore e ndërmarrjeve.

P4. Me cilin nga qëndrimet e cekura për zgjidhjen e nevojave shoqërore pajtoheni?
1 – Ndihmë sociale dhe humanitare për grupet në nevojë
2 – Zhvillim i ri, aftësimi i qytetarëve dhe punësimi
3 – Kërkimi i përgjegjësisë nga shteti dhe ndikimi i politikave publike (shtetërore)
4 - Nuk e di (spontanisht) / Pa përgjigje (spontanisht)

P5. Ju lutemi për secilën nga deklaratat që vijojnë a pajtoheni?

	Nuk pajtohem	Pajtohem	ND	PP
Qytetarët kanë përgjegjësi që ti respektojnë ligjet, duke përfshirë edhe obligimet që dalin nga ato.				
Qytetarët kanë përgjegjësi të marrin pjesë në aktivitete jopartiake politike (peticione, bojkot, protestë, letër në gazetë).				
Qytetarët kanë përgjegjësi të marrin pjesë vullnetarisht në aktivitetet në bashkësi.				
Qytetarët kanë përgjegjësi të marrin pjesë në aktivitetet e organizatave të shoqërisë civile (organizata qytetare, sindikata dhe kisha dhe bashkësi fetare).				
Qytetarët kanë përgjegjësi të dhurojnë (japin kontribute bamirëse).				
Qytetarët kanë përgjegjësi ta ruajnë mjedisin jetësor.				

II Fryma publike

P6. Ju lusim që për secilin nga aktivitetet që vijojnë, na thoni në çfarë shkalle mendoni se është e arsyeshme ose e paarsyeshme, duke e shfrytëzuar shkallën nga 1 deri 10.

	Asnjëherë					Gjithnjë				
Të kërkoni beneficione nga shteti për të cilat nuk keni të drejtë.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Ta shmangni pagesën e tatimit nëse keni rast për këtë.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Të paguani në të holla të gatshme për shërbime (lyerje, pastrim, ndreqje etj.) që të shmangen tatimet.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Të pranoni ose të jepni mitë për punë që është (e keni) obligim.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Të mos paguani për transport publik.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Të mos paguan i për shërbimet komunale (ujë, mbeturina, taksa rruge etj.).	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Të pini duhan në vend të ndaluar me ligj.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Të vozitni i dehur.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Të hidhni mbeturina në vende që nuk janë caktuar për këtë.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

P7. Sa nga bashkëqytetarët (qytetarë të Republikës së Maqedonisë) e bëjnë këtë?

	Pothuaj të gjithë	Shumë	Pak	Pothuaj askush	ND	PP
Kërkojnë beneficione nga shteti për të cilat nuk kanë të drejtë.						
Shmangin pagesën e tatimit nëse kanë mundësi për këtë.						
Pranojnë/japin mitë për punë që (e kanë) është obligim.						
Nuk i paguajnë shërbimet komunale (ujë, mbeturinat etj.).						
Pinë duhan në vende të ndaluara me ligj.						
Hedhin mbeturina në vende që nuk janë caktuar për këtë.						

P8. Ju lusim të na tregoni mendimin tuaj për secilën nga deklaratat që vijojnë.

	Plotësisht pajtohem	Pjesërisht pajtohem	As pajtohem, as nuk pajtohem	Pjesërisht nuk pajtohem	Aspak nuk pajtohem	ND	PP
Nëse dikush ka informatë që do të ndihmojë në zbatimin/plotësimin e drejtësisë, nëse ai/ajo duhet ta thotë informatën?							
Njerëzit duhet ta shohin punën e tyre dhe të mos merren shumë me atë që flasin ose bëjnë të tjerët.							

III. Niveli i socializimit

P9. Do t'ju pyes sa kohë më shpesh shpenzoni për punë të caktuara. Për çdo aktivitet, Ju lusim më thoni nëse e bënë çdo javë/përafërsisht çdo javë, një herë deri në dy herë në muaj, vetëm disa herë në vjet ose aspak nuk e bëni?

	Së paku një herë në javë	1-2 herë në muaj	Disa herë në vjet	Aspak nuk kaloj	ND	PP
Sa shpesh jeni me familje tuaj më të ngushtë/ose më të gjerë, me përjashtim të atyre me të cilët jetoni?						
Sa shpesh kaloni me miqtë?						
Sa shpesh shoqëroheni me kolegët nga puna ose profesioni, jashtë nga orari i punës?						
Sa shpesh shkoni në kishën, xhaminë tuaj ose ndonjë tempull?						
Sa shpesh shoqëroheni me njerëz në klubet sportive, rekrijuese ose hobi organizatat, shkollat e vallëzimit etj.?						

IV. Pjesëmarrja në aktivitetet jopartiake politike

P10. Pyetjet e ardhshme kanë të bëjnë me format e ndryshme në aktivitetet jopartiak politik. Ju lusim më thoni nëse keni marrë pjesë, nëse do të kishit marrë pjesë ose asnjëherë nuk do të kishit marrë pjesë në ato.

	Po, kam marrë pjesë në 5 vitet e fundit	Jo, por do ët kisha marrë pjesë	Asnjëherë nuk do të kisha marrë pjesë	ND	PP
A keni nënshkruar peticion.					
Keni marrë pjesë në protestë paqësor (demonstrata, miting).					
Bashkëngjitje në bojkot (mos blerja e prodhimeve të caktuara, mos pagesa e llogarive).					
Bllokimi i rrugëve dhe objekteve (ndërtesa, fabrika, institucione).					
Keni përdorur ditarin e qytetarëve.					
Tjetër (përmendni) _____.					

V. Aktivitet vullnetar në bashkësi

P11. A keni marrë pjesë në 12 muajt e fundit në aksione vullnetare (mbledhje ku është biseduar për problemet në komunën tuaj, pastrimi i rrugëve etj.) në bashkësinë tuaj?

1 – Po, kam marrë pjesë 2 – Jo, nuk kam marrë pjesë 3 – Nuk ka pasur aksion vullnetar

Nuk e di (spontanisht) Pa përgjigje (spontanisht)

P12. Nëse keni marrë pjesë, sa kohë në vjet keni përdorur për këto aktivitete? Ju lusim jepni vlerësim për numrin e orëve: _____ orë

Nuk e di (spontanisht) Pa përgjigje (spontanisht)

VI. Pjesëmarrja dhe aktiviteti i qytetarëve në organizatat e shoqërisë civile

P13. Tani do të lexoj disa forma të shoqërimit të qytetarëve. Ju lutem për secilën prej tyre të na thoni a jeni anëtar aktiv ose joaktiv.

	Anëtar aktiv	Anëtar joaktiv	Nuk jam anëtar	ND	PP
Kishat dhe organizatat fetare					
Sindikatat					
Partitë politike					
Organizatat qytetare (joqeveritare, shoqatat e qytetarëve)					

P14. Nëse jeni anëtar në njërën nga format e përmendur të shoqërimit, a paguani anëtarësim?
0 – Jo 1 – Po 2 – Nuk jam anëtar Nuk e di (spontanisht) / Pa përgjigje (spontanisht)

P15. Tani do të lexoj listë të organizatave qytetare nga sektorë të ndryshëm. Për secilën prej tyre, a mund të na thoni a jeni anëtar dhe nëse jeni, a jeni anëtar aktiv ose jo aktiv.

	Anëtar aktiv	Anëtar joaktiv	Nuk jam anëtar	ND	PP
Organizata për demokraci, të drejtat e njeriut dhe sundimi i të drejtës					
Organizatat për fëmijë, të rinj dhe studentë					
Organizatat për gra dhe çështje gjinore					
Organizatat për mjedis jetësor dhe natyrë (organizata ekologjike)					
Organizata për shëndet dhe shëndetësi					
Organizatat për personat me handikap					
Organizatat për zhvillim rural					
Organizata sociale dhe humanitare					
Organizatat për sport, hobi dhe rekrijim					
Organizatat për kulturë dhe arsim					
Organizatat profesionale					
Organizatat e konsumatorëve					

P16. Nëse jeni anëtar në ndonjërën nga organizatat e lartpërmendura qytetare, a paguani anëtarësim?
0 – Jo 1 – Po 2 – Nuk jam anëtar Nuk e di (spontanisht) / Pa përgjigje (spontanisht)

P17. Për cilat dy nga format e shoqërimit vullnetar (pa kompensim, vullnetarisht) keni punuar?
1 – Kisha dhe bashkësi fetare 2 – Sindikata 3 – Parti politike
4 – Organizata qytetare (shoqata të qytetarëve) 5 – Nuk kam punuar vullnetarisht

P18. Ju lusim na thoni për cilat dy (2) nga organizatat qytetare të lartpërmendura keni punuar vullnetarisht?
1 – Organizata për demokraci, të drejta të njeriut dhe sundimi i të drejtës (anti korrupsioni)
2 – Organizata për fëmijë, të rinj dhe studentë
3 – Organizatat për gra dhe çështje gjinore
4 – Organizata për mjedis jetësor dhe natyrë (organizata ekologjike)
5 – Organizata për shëndet dhje shëndetësi
6 – Organizata për persona me handikap
7 - Organizatat për zhvillim rural
8 - Organizata sociale dhe humanitare
9 - Organizatat për sport, hobi dhe rekrijim
10 - Organizatat për kulturë dhe arsim
11 - Organizatat profesionale
12 - Organizatat e konsumatorëve
13 – Nuk kam punuar vullnetarisht

P19. Nëse keni punuar vullnetarisht,m sa orë në muaj keni punuara si vullnetar në këto organizata? Ju lusim jepni vlerësim për orët: _____ orë

P20. Nëse periudhën e tanishme e krahasoni me periudhën para viti 2007, a keni marrë pjesë në këto organizata:
1 – Më shumë 2 – Pothuaj njëlloj 3 – Më pak 4 – Nuk i përkas asnjërës

P21. Pse këto organizata janë të rëndësishme për ju?
1 – Sepse i ndihmojnë bashkësisë time
2 – Sepse misioni i tyre është në pajtim me atë në çka besoj
3 – Sepse siguroj të ardhura plotësuese dhe përfitime tjera personale nga organizata
4 – Për shkak të mundësisë për socializim (të njoftoj njerëz të ri, të shoqërohem etj.)
5 – Për shkak të mundësisë për zhvillim personal (fitimi i njohurive dhe përvojave të reja)
6 – Për shkak të mundësisë për fitimin e autoritetit dhe respekt në shoqëri
7 – Nuk i takoj asnjërës

VII. Bamirësia

Qëndrime dhe motive

P22. A keni dhuruar (të holla ose të mira) për qëllime bamirëse në 12 muajt e fundit?

1 - Po, rregullisht, pothuaj çdo muaj dhe për çdo aksion
2 - Po, disa herë
3 - Jo, por do të kisha dhuruar
4 - Jo, nuk do të kisha dhuruar

P23. Pse dhuroni (jepni kontribute bamirëse)?

	Jo	Po	ND	PP
Për shkak të përgjegjësisë morale, njerëzit duhet të ndihmohen mes veti				
Sepse kjo është në interes për shoqërinë				
Sepse ngushëllohem me ata, nga keqardhja				
Që të bëj diçka për kthim/t'ua kthej				
Sepse kam mjaft dhe mund tall jap				
Ishte e pakëndshme ti refuzoj				
Që të lirohem nga ata që kërkojnë me këmbëngulje				
Për shkak të interesit personal				
Tjetër				
Nuk kam dhënë				

P24. Nëse nuk dhuroni, pse?

	Jo	Po	ND	PP
Secili duhet të kujdeset për veten				
Nuk kam as për vete sa duhet (mua më nevojitet ndihmë)				
Nuk jam i informuar si përdoren mjetet, nuk besoj në përdorimin, dyshoj në keqpërdorimin				
Nuk besoj se do të arrijnë sukses/rezultat				
Dëshiroj, por nuk di si				
Tjetër				
Dhuroj				

Qëllimet dhe grupet qëllimore

P25. Nëse keni dhuruar në 12 muajt e fundit, për cilin qëllim më së shpeshti keni dhuruar?
(numërim vullnetar) _____ 0 - Nuk dhuroj

P26. Nëse dhuroni, për cilat dy qëllime e bëni këtë?

	Fusha	Përshkrim
1	Kisha dhe bashkësi fetare	Ndërtimi i objekteve fetare dhe avancimi i fesë
2	Demokracia, të drejtat e njeriut dhe sundimi i të drejtës	Mosrespektimi dhe zbatimi i ligjeve, kërkimi i përgjegjësisë nga shteti, zgjedhje fer dhe të lira, tregtia me njerëz, anti korrupsioni
3	Fëmijët, të rinjtë dhe studentët	Të drejtat e fëmijëve, çështjet e të rinjve, gjimnazistëve dhe studentëve
4	Gratë dhe çështjet gjinore	Të drejtat e gruas, barazia gjinore etj.
5	Mjedisi jetësor dhe natyra	Mbrojtja e mjedisit jetësor, ruajtja e natyrës, mbrojtja e kafshëve, zhvillim i qëndrueshëm, ushqim i shëndoshë, ujërat, pyjet etj.
6	Shëndeti dhe shëndetësia	Shëndeti, parandalimi i sëmundjeve, mjekët etj.
7	Kultura, arti dhe arsimi	Kultura, arti, shoqatat kulturore-artistike, filmi, muzika, teatri etj.
8	Personat me nevoja të veçanta	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe sigurimi i kushteve më të mira për jetë për personat me nevoja të veçanta
9	Zhvillimi rural	Bujqësia, zhvillimi i fshatit, infrastruktura, ujëvarat, kanalizimi etj.
10	Kujdesi social (humanitar)	Prindër me një bashkëshort, ndarja e ndihmës, kujdesi për fëmijët pa prindër, mbrojtja dhe kujdesi i grupeve të margjinalizuara, personat pa shtëpi etj.
11	Sport, hobi dhe rekrijimi	Futboll, boks, çiklizëm, gjuetarë, peshkatarë, klube për grumbullimin e pullave postare, kafshë shtëpiak etj.
12	Organizata profesionale	Profesion i caktuar: avokatë, gazetarë, stomatologë, mjek etj.
13	Parti politike	Grupe të organizuara të qytetarëve të cilët angazhohen për pjesëmarrje në pushtet
14	Sindikata	Kujdesi për punëtorët, mbrojtja e të drejtave të tyre etj.
15	Tjetër - përmend	
	Nuk dhuroj	

P27. (o88) Nëse, dhuroni, cili nivel për ju është prioritar për dhurim?

1 – Lokalisht në bashkësinë tuaj lokale
2 – Në komunën ose qytetin tuaj
3 – Për rajonin tuaj (në Maqedoni)
4 – Nacional (në nivel të gjithë Maqedonisë)
5 - Ndërkombëtarisht (mbështetje jashtë nga Maqedonia)

VIII. Përgjegjësia ndaj mjedisit jetësor

P28. Ju lusim për secilën nga deklaratat që vijojnë më thoni a pajtoheni?

	Plotësisht pajtohem	Pjesërisht pajtohem	Pjesërisht nuk pajtohem	Aspak nuk pajtohem	ND	PP
Duhet të rriten tatimet (taksa ekologjike), nëse mjetet e grumbulluara në këtë mënyrë shfrytëzohen për pengimin e ndotjes së mjedisit jetësor						
Duhet të ngrihen standardet për ndërtim për shkak të kursimit të energjisë (për efikasitet energjetik)						
Duhet të caktohet afati për përjashtimin e automjeteve të udhëtarëve të cilët nuk i plotësojnë standardet ekologjike për gazrat që emetohen?						
Duhet të ndalohet puna e fabrikave-ndotëse të cilët nuk i plotësojnë standardet ekologjike?						
Duhet të ketë dënime të rrepta/të larta për hedhjen e mbeturinave në vende që nuk janë caktuar për këtë dhe deponi jolegale						
Duhet të paguhet kaucion për ambalazh (shishe plastike dhe kanaçe)						
Ndalesa për përdorimin e qeseve plastike dhe zëvendësimi i tyre me qese prej pëlhure dhe letre (ose nga material tjetër) është i arsyeshëm						
Seleksionimi i mbeturinave nga amvisëritë për shkak të reciklimit duhet të jenë të obligueshme						
Duhet të ndalohet gjuetia e kafshëve të egra						

Shtojcë. Struktura e ekzemplarit

Ekzemplari përfshiu 1.050 të anketuar. Korniza e popullatës së ekzemplarit më të vjetër se 18 vjet, ndërsa kriteret për reprezentim ishin: gjinia, mosha, përkatësia etnike, vendi i banimit dhe rajoni.

Gjinia	%
Meshkuj	50,3
Femra	49,7
Mosha	**%**
18-29 vjet	25,6
30-39 vjet	21,6
40-49 vjet	19,9
50-65 vjet	22,1
Mbi 65 vjet	10,8
Përkatësia etnike	**%**
Maqedonas/e	63,2
Shqiptar/e	24,7
Turk/e	4,0
Rom/e	3,3
Serb/e	1,6
Vlleh/e	0,6
Boshnjak/e	1,2
Tjetër	1,3
Përkatësia e religjionit	**%**
Ortodokse	66,6
Islame	31,6
Katolike	0,2
Tjetër	0,3
Nuk i përkas as një religjioni/ateist	1,3
Të qenit religjioz	**%**
Person religjioz	86,8
Person jo religjioz	10,6
Ateist	2,7
Statusi i punës	**%**
I punësuar në sektorin publik	17,8
I punësuar në sektorin privat	34,1
Bujk	2,6
Student	8,7
Amvise	6,2
I papunësuar	18,5
Pensionist	12,2
Statusi social (vetë perceptim)	**%**
Klasë e lartë	2,3
Klasë më e lartë e mesme	22,8
Klasë më e ulët e mesme	33,8
Klasë punëtore	31,2
Klasë më e ulët	9,9
Shkollimi	**%**
Me arsimim të papërfunduar fillor	2,1
Fillor	14,9
Mesëm	52,7
I lartë/sipëror	30,4

Vendi i banimit	%
Rural (fshat)	39,1
Urban (qytet)	39,7
Shkup	21,1
Të ardhura mujore për anëtar në amvisëri	**%**
deri 1500 den.	6,3
1500 - 3.000 den.	7,0
3.001 - 4.000 den.	8,3
4.001 - 5.000 den.	10,1
5.001 - 6.500 den.	9,9
6.501 - 8.000 den.	11,5
8.001 - 11.000 den.	12,3
11.001 - 15.000 den.	12,3
15.001 - 24.000 den.	11,0
Mbi 24.000 den.	11,3
Orientimi politik	**%**
I majtë	5,6
2	4,2
3	4,7
4	3,5
5	12,8
6	4,4
7	4,3
8	5,7
9	4,3
I djathtë	9,0
Nuk e di	27,2
Pa përgjigje	14,4
Simpatizues i cilës parti politike jeni (spontanisht)?	**%**
VMRO-DPMNE	21,9
LSDM	13,7
BDI	6,4
PDSH	5,6
Demokracia e re	2,0
Tjerë	6,0
Nuk jam simpatizues i asnjërës	44,4
Rajoni	**%**
I Shkupit	29,3
Juglindor	9,0
Lindor	9,7
Verilindor	8,6
I Vardarit	6,7
Jugperëndimor	9,0
I Pollogut	17,1
I Pellagonisë	10,7